

Udhëzues për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit

Qershor 2024

ISBN:

Botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri
Sheshi “Italia”, Tiranë
Tel: +35542240001
E-mail: pm-al@osce.org

© 2024 Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Të drejtat e autorit: Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Materiali që përmban ky botim mund të citohet ose të rishtypet, me kusht që të njihet autorësia e tij dhe një kopje e botimit që përmban materialin e rishtypur t'i dërgohet Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Çdo përdorim tjetër i këtij materiali, që përfshin, por nuk kufizohet në përdorimin komercial apo në krijimin e punimeve që rrjedhin nga ky botim, kërkon lejen me shkrim të Prezencës së OSBE-së.

Dizenjimi: Florian Bregu

INFORMACION LIGJOR:

Materialet e përfshira në këtë botim, janë vetëm për informacion të përgjithshëm të ofruara për një kontekst specifik. Pikëpamjet e shprehura në të janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Përmbajtja

PROLOG	08
HYRJE	09
1. MBI MEKANIZMIN KOMBËTAR TË REFERIMIT PËR VIKTIMAT DHE VIKTIMAT E MUNDSHME TË TRAFIKIMIT	10
1.1 Katër shtyllat e zbatimit të MKR-së	11
2. PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT	15
3. QASJA ME NË QENDËR VIKTIMËN	19
3.1 Zbatimi i qasjes me në qendër viktimën	19
3.2 Qasja me në qendër viktimën në procesin penal ndaj trafikantit	22
4. QASJA E PËRQENDRUAR TEK KUJDESI DHE NDJESHMËRIA NDAJ TRAUMËS	24
4.1 Zbatimi i qasjes së përqendruar tek kujdesi ndaj traumës	25
4.2 Udhëzime për profesionistët	27
5. MBROJTJA E POSAÇME E FËMIJËVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT	30
5.1 Interesi më i lartë i fëmijës	31
5.2 Interesi më i lartë i fëmijës gjatë procesit të identifikimit	32
5.3 Interesi më i lartë i fëmijës gjatë procedimit penal	00
6. FAKTORËT E VULNERABILITETIT QË LIDHEN ME PËRKATËSINË GJINORE TË VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT	33
6.1 Pabarazitë gjinore	33
6.2 Pabarazitë gjinore dhe trafikimi i qënieve njerëzore	34
6.3 Një qasje e ndjeshme gjinore për viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit	35
6.4 Shërbime me ndjeshmëri gjinore për viktimat	37
6.5 Ndërgjegjësimi për ndikimin e dhunës me bazë gjinore	38
7. PJESËMARRJA E TË MBIJETUARAVE TË TRAFIKIMIT NË MKR	40
7.1 Rëndësia e Pjesëmarrjes së të Mbijetuarve në MKR	40
7.2 Konsiderata në lidhje me përfshirjen e të mbijetuarave/mbijetuarve	42

8. PËRGJIGJA E MKR-SË NË EMERGJENCA DHE KRIZA HUMANITARE

- 8.1 Trafikimi i personave gjatë krizave humanitare
- 8.2 Vulnerabiliteti ndaj trafikimit i personave në komunitetet e prekura nga kriza
- 8.3 Përgjigja e MKR në kohe krizash dhe emergjencash
- 8.4 Mbrojtja dhe ndihma për personat e trafikuar gjatë një krize humanitare

9. MONITORIMI I MEKANIZMIT KOMBËTAR TË REFERIMIT

- 9.1 Koordinimi i veprimtarisë së MKR-së dhe monitorimi
- 9.2 Konsiderata për MKR-në në Shqipëri
- 9.3 Mjete të mundshme për të monitoruar Mekanizmin Kombëtar të Referimit
- 9.4 Shembull i një pyetësoi për Monitorimin e MKR-së

REFERENCAT

44

44

44

45

46

48

48

49

50

51

52

Falënderime

Ky udhëzues u hartua nën kujdesin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Prezenca në Shqipëri, në vijim të mbështetjes së institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile në vend për hartimin e një marrëveshjeje për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit, e cila u miratua në qershor 2023.

Udhëzuesi u përgatit nga Mariana Meshi, Drejtore e organizatës “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”, Juliana Rexha, Oficere Kombëtare kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Prezencën e OSBE-së në Shqipëri dhe Prof.As.Dr. Irida Agolli, pedagoge e Shkencave Sociale.

Udhëzuesi përmban rekomandime dhe udhëzime nga dy manualët kryesore të OSBE/ODIHR mbi Mekanizmat Kombëtarë të Referimit¹, të njohura si modele udhërrëfyese për të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së për ngritjen dhe zbatimin e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit.

¹ Edicioni i parë dhe i dytë i Manualeve të OSBE/ODIHR mbi Mekanizmat Kombëtarë të Referimit: https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/510551_2.pdf dhe <https://www.osce.org/odihr/13967>

Prolog



2 Thënie të të mbijetuarave të trafikimit, marrë nga botimi i organizatës “Të ndryshëm dhe të Barabartë” me titull “Album me piktura nga viktimat e trafikimit “Une e lashe te kaluaren pas”: <https://differentandequal.org/sq/une-e-lashe-te-kaluaren-pas/>

Hyrje

Historia e trafikimit jo në çdo rast mbyllet në momentin që viktimat e trafikimit bie në kontaktin fillestar me një profesionist të shërbimeve sociale apo punonjës policie. Padyshim, identifikimi i hershëm dhe i saktë i situatës së trafikimit është hapi më i rëndësishëm për vënien në lëvizje të sistemit të mbrojtjes, por rëndom trafikimi mund të vazhdojë dhe pas identifikimit fillestar. Ndërsa trauma e përvojës së trafikimit dhe sfidat e rimëkëmbjen e shoqërojnë të mbijetuarin e trafikimit gjatë duke penguar shpesh dhe përballjen me profesionistët që e asistojnë.


Ndaj zbatimi i një qasjeje që ka në qendër viktimën e trafikimit dhe që është e ndjeshme ndaj traumës është hapi kryesor për t'i dhënë fund abuzimit dhe shfrytëzimit, për shkak se trafikimi nuk është thjesht një aktivitet kriminal por para së gjithash shkelje e të drejtave të njeriut me pasoja për vetë viktimën, shoqërinë në të tërësi, institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile që janë aktive në këtë fushë.

I konceptuar si një material udhërrëfyes për zbatimin e duhur të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit, ky udhëzues përmban rekomandime, këshilla orientuese, këndvështrime praktike të nxjerra nga Manualët e OSBE/ODIHR mbi Mekanizmat Kombëtarë të Referimit dhe manuale të ndryshme në lidhje me hapat për identifikimin, referimin dhe asistencën e viktimave të trafikimit.

Udhëzuesi mund të konsiderohet si një dokument mbështetës i Marrëveshjes për Mekanizmin Kombëtar të Referimit në Shqipëri, i cili tashmë është ridimensionuar me miratimin e marrëveshjeje së re për zbatimin e tij në qershor 2023. Anëtarët e marrëveshjes zotohen të identifikojnë, mbrojnë e referojnë për asistencë viktimat e trafikimit në vend, duke zgjeruar gamën e asistencës sociale e ligjore, në respektim të të drejtave të viktimave si një kategori e veçantë e viktimave të krimit. Nisur nga kjo marrëveshje e re, Prezenca e OSBE-së sjell këtë udhëzues për të lehtësuar të kuptuarit dhe zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit drejt mbrojtjes së menjëhershme, aksesit në drejtësi dhe mbështetjes për çdo person të trafikuar të identifikuar në vend.

Udhëzuesi mund të përdoret nga çdo profesionist i institucioneve dhe organizatave që zbatojnë Mekanizmin Kombëtar të Referimit, si përsa i përket veprimtarisë së tyre për hartimin e politikave e procedurave të ndryshme në lidhje me këtë tematikë si dhe trajtimit të rasteve të trafikimit. Orientimi dhe formimi profesional i punonjësve të ngarkuar me zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit është një prej parakushteve thelbësore për zbatimin korrekt të tij, nisur veçanërisht nga fakti që trafikimi është një fenomen në ndryshim të vazhdueshëm dhe se adresimi i nevojave të viktimave të trafikimit kërkon një njohje të hollësishme të parimeve të mbrojtjes që integrohen në çdo hap të komunikimit me personat e trafikuar.

I. Mbi Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit



Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) është një kuadër bashkëpunimi nëpërmjet të cilit institucionet shtetërore përmbushin detyrimet e tyre për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e personave të trafikuar, duke bashkërenduar përpjekjet e tyre në një partneritet strategjik me shoqërinë civile.

Objekti kryesor i MKR-së është të sigurojë **respektimin e të drejtave të të personave të trafikuar** dhe të ofrojë një **mënyrë efektive për t'i drejtuar ata drejt shërbimeve të posaçme**. Në thelb, MKR merret me procesin e identifikimit dhe referimit për asistencë të viktimave të trafikimit, duke siguruar respektimin e të drejtave të njeriut. Koncepti i MKR-së integron konceptin e mbrojtjes së personit të trafikuar jo vetëm në procedurat e mbrojtjes sociale dhe asistencës por dhe në ndjekjen penale të trafikantëve. Kështu, MKR trajton një gamë të gjerë të të drejtave si:

- Mosdiskriminimi
- Asistenca juridike
- Mbrojtja e të dhënave
- Privatësia
- Pëlqimi i informuar
- Akses në shërbime shëndetësore dhe shoqërore
- Akses në strehim
- Periudha e rikuperimit dhe reflektimit
- Strehimi i përkohshëm ose i përhershëm
- Kompensimi
- E drejta për të përfituar azil dhe moskthimi i detyrueshëm dhe i pasigurt në vendin e origjinës.

Për të realizuar këto të drejta, në MKR përfshihen të gjitha institucionet shtetërore dhe ato organizata të shoqërisë civile që ndeshen me viktimat trafikuara gjatë punës së tyre, duke bashkërenduar veprimet e nevojshme për të siguruar ndihmën dhe mbrojtjen e duhur për personat e trafikuar, në çdo fazë të procesit të referimit.

Qëllimi kryesor i MKR-së është të sigurojë që të drejtat e njeriut të viktimave të trafikimit të respektohen, pavarësisht nga prejardhja e tyre, kombësia, aktivitetet ku mund të jenë përfshirë gjatë kohës që ishin nën ndikimin e një trafikanti, ose vullneti i tyre për të bashkëpunuar me autoritetet ligj zbatuese. Këtu përfshihen ata që trafikonhen brenda vendit (brenda kufijve të vendit) si dhe jashtë vendit (përtej kufijve shtetërorë), nëpërmjet internetit.

MKR-ja është krijuar për të ofruar një mënyrë efektive për këta individë që të referohen në një sërë shërbimesh (qoftë të lidhura me institucionet e zbatimit të ligjit apo ato të ndihmës.



1.1 Katër shtyllat e zbatimit të MKR-së

Sipas Manualit të OSBE/ODIHR³, MKR-ja duhet të sigurojë respekt për të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e të gjithë të rriturve dhe fëmijëve që janë viktimat të trafikimit. MKR duhet t'i sigurojë viktimave të trafikimit akses në katër Shtyllat e MKR-së, siç detajohet më poshtë:

- Identifikimi plus Mbrojtja
- Mbështetja individuale dhe akses në shërbime;
- Përfshirja Sociale
- Drejtësia penale dhe dëmshpërblimi

Shtylla 1: Identifikimi dhe Mbrojtja

Detyrimi për identifikimin dhe njohjen e hershme të viktimave të trafikimit është thelbësor për suksesin e MKR-së dhe ofron portën kryesore për mbrojtjen e pakushtëzuar, mbështetjen dhe aksesin në shërbime. Është gjithashtu jetike për sistemet e drejtësisë penale në ndjekje dhe dënimin e trafikantëve.

Ka shumë arsye pse viktimat dhe të mbijetuarit/mbijetuarat kanë shumë frikë t'u drejtohen autoriteteve pas largimit nga kontrolli i drejtpërdrejtë i trafikantëve. Shumë prej tyre mbeten të bllokuar në ciklet e shfrytëzimit dhe të trafikimit dhe për këtë arsye janë 'të padukshëm' për ata që mund t'i ndihmojnë. Njerëzit që janë ende në situatë trafikuimi ose që dalin nga kjo situatë janë nën presion të madh dhe shpesh nuk janë mirë fizikisht ose psikologjikisht; ata që janë larguar nga trafikantët muaj apo vite më parë, por kanë qenë pa mbështetjen e duhur, janë ende në nevojë të madhe, por shpesh u mungon besimi ose njohuria e nevojshme për të hyrë në procedurat e identifikimit.

Ndaj, komunikimi që tregon ndjeshmëri ndaj traumës është thelbësor në çdo fazë të identifikimit, si atij fillestar dhe atij formal. Profesionistët që duken si të largët, jo mirëpritës ose armiqësorë mund të frikësojnë dhe të pengojnë viktimat e trafikimit që kanë mësuar të kenë frikë nga njerëzit e tjerë dhe që qëndrojnë psikologjikisht 'në roje' për shenjat më të vogla të armiqësisë.

Profesionistët që punojnë në çdo shërbim ose sektor që mund të kenë kontakt me një person që ata dyshojnë se mund të jetë viktimë e trafikimit dhe bëjnë një referim të MKR-së për identifikim formal duhet të jenë të trajnuar mbi qasjen e informuar për komunikimin që tregon ndjeshmëri ndaj traumës.

Këtu përfshihen:

- Punonjësit dhe profesionistët e OJF-ve që punojnë brenda organizatave të shoqërisë civile.
- Ofruesit e shërbimeve shëndetësore, administratorët dhe stafi i përfshirë në të gjitha nivelet në spitale, klinika dhe praktika mjekësore.
- Punonjësit në linjat ajrore, anijet, trenat, taksitë dhe mënyra të tjera transporti që përdoren për trafikim.
- Punonjësit në industrinë e mikpritjes dhe argëtimit.
- Mësuesit, administratorët dhe stafi në shkollat, jetimore, kolegje, universitete dhe të tjera qendra edukative.
- Inspektorët e punës, detarë, të minierave dhe bujqësisë, inspektorët e shëndetit dhe sigurisë.
- Stafi në të gjitha nivelet brenda qendrave të paraburgimit administrativ, objekteve të paraburgimit dhe burgjeve.

³ National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook – Second Edition [Mekanizmi Kombëtar i Referimit – Bashkimi i përpjekjeve për të Mbrojtur të Drejtat e Personave të Trafikuar: Manual Praktik, Edicioni i Dytë]. OSBE, Janar 2022: https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/510551_2.pdf

- Juristët që punojnë në të gjitha fushat e së drejtës: ligji penal, azili dhe migracioni, shëndeti mendor, strehimi, punësimi, mirëqenia sociale, ligji për fëmijët dhe familjen, si dhe çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Përkthyes profesionistë dhe ndërmjetës kulturorë.
- Anëtarët e sindikatave.
- Ofruesit e shërbimeve sociale.
- Policia dhe zyrtarë të tjerë të zbatimit të ligjit (jo të specializuar në trafikim), përfshirë prokurorët, gjyqtarët dhe stafi tjetër.
- Zyrtarët e ambasadave dhe konsullatave.
- Psikologë dhe këshillues (përfshirë personelin mjekësor).
- Stafi i agjencive të punësimit/rekrutimit dhe ndërmjetësve të tjerë që lehtësojnë punësimin (duke përfshirë edhe në nivel ndërkombëtar)
- Personeli i sektorit bankar dhe financiar.
- Personeli i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).
- Stafi i institucioneve fetare dhe objekteve të kultit.
- Publiku i gjerë.

Ata që njihen me termin “reaguesit e parë” ose autoritetet e ngarkuara me identifikimin paraprak të viktimave të mundshme të trafikimit; autoritetet e ngarkuara me identifikimin formal të viktimave të trafikimit dhe dhënien e të drejtave të lidhura me to, përfshirë:

Linja ose reaguesit e parë:

- Policia dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit.
- Punonjësit e migracionit (policia e kufirit kufitare, zyrtarët e migracionit, zyrtarët konsullorë dhe të vizave, doganierët, shërbimet detare, rojet bregdetare, autoritetet portuale).
- Punonjësit socialë nga shërbimet sociale të akredituara.
- Punjoësit e mbrojtjes së fëmijëve.
- Inspektorët e punës.
- Zyrtarët që punojnë në qendrat e paraburgimit, ambientet e paraburgimit dhe mjediset e burgut.
- Gjyqtarët dhe prokurorët.
- OJQ-të dhe profesionistët e akredituar brenda OJF-ve të specializuara të masave kundër trafikimit dhe organizatave të shoqërisë civile.

Shtylla 2 : Mbështetja individuale dhe Aksesit në Shërbime

Shtylla e Dytë ofron mbështetje individuale dhe akses në shërbimet e shumë agjencive që duhet të vijojnë drejtpërdrejt nga Shtylla e Parë (Identifikimi + procedurat) dhe vazhdojnë për aq kohë sa të jetë e mundur për viktimat e trafikimit.

Kjo përfshin (por nuk duhet të kufizohet në):

- Kujdesi për nevojat praktike, financiare dhe materiale.
- Caktimi i profesionistëve individualë të mbështetjes, duke përfshirë avokatë të pavarur për të rriturit dhe mbrojtës të fëmijëve.
- Vlerësimi i duhur dhe planifikimi i vazhdueshëm i sigurisë për të rriturit dhe fëmijët.
- Sigurimi i aksesit të hershëm dhe të vazhdueshëm në shërbimet e kujdesit shëndetësor.
- Sigurimi i aksesit të hershëm dhe të vazhdueshëm në këshillim dhe përfaqësim juridik falas për të gjitha çështjet ligjore.
- Sigurimi i akomodimit të sigurt dhe të përshtatshëm.

Të gjitha shërbimet dhe ofrimi në kohë i tyre janë vendimtare në jetën e viktimave dhe duhet të ofrohen nga profesionistët të cilët janë të **trajnuar e të informuar mbi traumat**. Kjo u lejon personave të trafikuar të krijojnë besim në sistemin e mbrojtjes dhe të qëndrojnë në kontakt me shërbimet pas largimit nga kontrolli i drejtpërdrejtë i trafikantëve.

Pas identifikimit fillestar ose formal, shumë të mbijetuar duhet të jetojnë për periudha të gjata (shpesh vite) në vështirësi. Ata mund të presin pafundësisht për njohjen e statusit ose për të zgjidhur çështjet e drejtësisë penale. Në të njëjtën kohë, përveç frikës nga trafikantët e tyre, ata shpesh përballen me varfërinë dhe mungesën e strehimit. Kjo mund të duket si një kohë e mëtejshme e vjedhur nga jeta e tyre dhe, në shumë raste pengon ecurinë normale të jetës familjare, jetës personale, aksesit në arsim, trajnim dhe punësim. Është një periudhë kur viktimat e trafikimit mund të ndihen të pashpresë dhe të dëshpëruar nëse mbeten pa mbështetjen e duhur, ose nëse nuk marrin informacion rreth mbështetjes që është e disponueshme.

Shtylla 3: Përfshirja sociale

Kalimi nga Faza e Dytë (Mbështetja individuale dhe aksesit në shërbime) duhet të jetë gradual dhe të mbështetet vazhdimisht për të siguruar që të mbijetuarit e trafikimit janë të pajisur për të krijuar një jetë të sigurt dhe të pavarur.

Përfshirja sociale përfaqëson të vetmen **formë të qëndrueshme të sigurisë dhe stabilitetit** për të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore. Nga momenti i identifikimit, vlerësimi dhe planifikimi i sigurisë së çdo të rrituri dhe fëmije duhet të përfshijnë planet për të ardhmen me hapa të dakortësuar nga vetë viktima.

Personat që i kanë mbijetuar trafikimit nuk duhet të lihen të luftojnë të izoluar në skajet e shoqërisë kudo që janë. Kjo krijon vetëm terren që trafikantët të veprojnë pa u ndëshkuar dhe mund të krijojnë rreze trafikimi dhe ritrafikimi, familjet e tyre dhe brezave të tyre të ardhshëm. Ka shumë pengesa dhe barriera për të hyrë në rrugën drejt përfshirjes sociale, duke përfshirë mungesën e strehimit, arsimimit, trajnimit dhe punësimit të sigurt dhe të përshtatshëm. Të kuptuarit se çfarë i nevojitet një të mbijetuarit për përfshirje sociale dhe ri-integrim kërkon njohjen e përvojave të tyre personale: shumë të rritur dhe fëmijë janë trafikuar fillimisht për shkak të një kombinimi të faktorëve të vulnerabilitetit të cilat rezultojnë në vështirësi sociale, marginalizim dhe përjashtim.

Rrugët drejt përfshirjes sociale dhe ri-integrimit janë gjithmonë shumë individuale dhe varen nga një sërë faktorësh. Në shumicën e rasteve, përfshirja sociale afatgjatë arrihet vetëm me mbështetje të vazhdueshme individuale, e cila gradualisht zvogëlohet ndërsa pavarësia arrihet në mënyrë progresive. Përfshirja sociale ka më shumë gjasa të jetë e qëndrueshme dhe e përhershme kur ndihma dhe shërbimet individuale të ofruara bazohen në metoda të punës të informuara që tregojnë ndjeshmëri për traumën dhe mbeten të disponueshme për personat e trafikuar edhe nëse është e nevojshme të kthehen përsëri. Shumë shpesh, profesionistët që punojnë ngushtë me të mbijetuarit dhe krijojnë një marrëdhënie besimi do të jetë të vetmit njerëz që janë plotësisht të vetëdijshëm për historinë e tyre të trafikimit dhe për këtë arsye janë të aftë të veprojnë me shpejtësi për të ndihmuar dhe këshilluar në çdo situatë të pafavorshme.

Shtylla 4: Ndjekja penale dhe kompensimi

Shtylla e katërt shpjegon se **bashkëpunimi i viktimës së trafikimit me sistemin e drejtësisë penale nuk duhet të jetë kusht për të hyrë në MKR dhe për të gëzuar të drejtat e lidhura me të. Megjithatë, ajo duhet t'u viktimave të trafikimit në çdo fazë përpara, gjatë ose pas përfshirjes së tyre me MKR-të.**⁴

Hetimet ndaj trafikantëve mund të jenë të gjata, të ndërlikuara dhe mund të zgjasin muaj ose vite. Gjatë kësaj periudhe viktimat mund të ekspozohen nga kërcënimeve ose hakmarrjes ndaj tyre dhe familjarëve. Rrishtet e tyre të arrestohen, ndalohen, ndiqen penalisht, dënohen, burgosen ose deportohen për vepra penale pa u identifikuar ndonjëherë si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Viktimat e trafikimit mund të kenë kryer krime si pasojë e drejtpërdrejtë e trafikimit ose për shkak se janë detyruar ta bëjnë këtë nga trafikantët. **Të gjitha viktimat e trafikimit janë viktimat të një krimi të rëndë,** pavarësisht nëse ata/ato veprojnë si informatorë apo dëshmitarë në hetimet penale të trafikantëve, ose janë vetë të akuzuar për vepra penale. Të drejtat për mbrojtje dhe mbështetje për viktimat që janë të përfshira në procesin penal, duke përfshirë parimin e përjashtimit nga dënimi, garantohen në të drejtën ndërkombëtare dhe atë vendase.

Është një fakt i njohur që viktimat e trafikimit janë më bashkëpunuese me institucionet ligj zbatuese kur komunikimi me to kryhet në dijeni të traumës që kanë kaluar dhe të rrezikut me të cilin ballafaqohen. Kjo duhet të zbatohet që në kontaktin e parë dhe të mbahet gjatë:

- Operacioneve policore
- Denoncimit të krimit si viktimë/dëshmitar ose fillimit të procedimit penal
- Hetimit të trafikantëve të dyshuar
- Seancave paraprake dhe seancave gjyqësore
- Procedurave për marrjen e të gjitha formave të kompensimit
- Ndjekjes pas gjykimit me viktimë-dëshmitarë dhe mbrojtjes së përkohshme ose afatgjatë të dëshmitarëve

4 National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook – Second Edition [Mekanizmi Kombëtar i Referimit – Bashkimi i përpjekjeve për të Mbrojtur të Drejtat e Personave të Trafikuar: Manual Praktik, Edicioni I Dytë]. OSBE, Janar 2022: https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/510551_2.pdf

II. Parimet mbi të cilat mbështetet Mekanizmi Kombëtar i Referimit



Një Mekanizëm Kombëtar Referimi efikas dhe funksional bazohet në parimet e shtjelluara më poshtë, për t'u marrë parasysh dhe zbatuar gjatë të gjitha fazave të identifikimit, asistencës dhe referimit të personave të trafikuar.⁵

Parimi 1. Epërsia e të Drejtave të Njeriut

Shteti ka përgjegjësinë sipas legjislacionit ndërkombëtar të veprojë me kujdesin e duhur për të **parandaluar** trafikimin e qenieve njerëzore, për të **hetuar** dhe ndjekur penalisht trafikantët dhe për të **mbrojtur** e ndihmuar viktimat e trafikimit.

Mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit (veçanërisht siguria e tyre) duhet të jetë prioriteti i parë i të gjitha masave kundër trafikimit. Masat për parandalimin ose mbrojtjen nuk duhet të ndikojnë negativisht në të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e njerëzve, veçanërisht të drejtat e atyre që janë trafikuar, emigrantëve, personave të zhvendosur brenda vendit, refugjatëve dhe azilkërkuessve. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut vendos të drejtat individuale në qendër të aktiviteteve dhe politikave kundër trafikimit.

Parimi 2. Partneriteti dhe Bashkëpunimi

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtja e viktimave kërkon një qasje shumë disiplinore dhe ndër sektoriale, përfshirë edhe të gjithë aktorët përkatës nga qeveria dhe shoqëria civile. Të gjitha organizatat që marrin pjesë në MKR angazhohen të punojnë së bashku (dhe të shmangin konkurrencën kundër të tjerëve në MKR) për të siguruar rezultate që janë në interesin më të mirë të viktimave të trafikimit. Qeveria është përgjegjëse për të siguruar një koordinim efektiv dhe efikas të MKR-së, duke përfshirë emërimin dhe zëvendësimin periodik të një Koordinatorit të duhur Kombëtar të nivelit të lartë. Qeveria është gjithashtu përgjegjëse për të siguruar që kostot e mbrojtjes dhe ndihmës së viktimave të trafikimit të mbulohen, qoftë nga buxheti i shtetit ose nga bashkëpunimi ndërkombëtar.

Parimi 3. Llogaridhënia

MKR-ja në tërësi jep llogari para Qeverisë, Parlamentit apo institucioneve përkatëse, ndaj të gjitha organizatave që i përkasin MKR-së si dhe ndaj viktimave të trafikimit. MKR-ja u cakton përgjegjësi të qarta (sipas mandateve të tyre) organizatave që marrin pjesë në strukturën e saj. Llogaridhënia kërkon vlerësime periodike të mënyrës se si funksionon MKR-ja në tërësi, si dhe të organizatave individuale të përfshira, me qëllim identifikimin e çdo mangësie dhe kryerjen e ndryshimeve sipas nevojës. Raportuesi Kombëtar ose institucioni që përmbush këtë rol, ka përgjegjësinë specifike për të informuar viktimat e trafikimit, për të gjetur se çfarë ndikimi kanë pasur mbi to masat e marra nga MKR-ja dhe organizatat e saj pjesëmarrëse dhe raportimin mbi përvojat e tyre (dhe opinionet se çfarë mund të bëhet më mirë) në mënyra që mbrojnë privatësinë e tyre dhe shmangin zbulimin e identitetit të tyre.

5 Ibid.

Parimi 4. Qasja me më Qendër Viktimën, Qasja e Informuar për Traumën dhe e Ndjeshme ndaj Gjinisë dhe Fëmijës

Një qasje e përqendruar te viktima garanton prioritetin për identifikimin e viktimave të supozuara dhe nxjerrjen e tyre nga kontrolli i trafikantëve ose kujtudo tjetër përgjegjës për shfrytëzimin e tyre. Kjo qasje siguron që mbrojtja dhe ndihma t'i vihen në dispozicion menjëherë kujtudo që identifikohet si viktimë e supozuar. Në përcaktimin e veprimeve të saj në lidhje me viktimat, MKR-ja merr parasysh moshën dhe gjininë e viktimave, së bashku me çdo traumë ose lëndim që kanë pësuar. Ajo siguron që të mos ketë diskriminim gjatë procesit penal ose ofrimit të shërbimeve për viktimat e trafikimit (d.m.th., shërbimet mbështetëse dhe mbrojtëse u ofrohen pa diskriminim të gjitha kategorive të viktimave të mundshme të trafikimit).

Një qasje e përqendruar te viktima respekton parimin se veprimet për të mbrojtur dhe ndihmuar viktimat (të rriturit dhe fëmijët) nuk duhet të shkaktojnë dëm ose paragjykim ndaj tyre. Në rastin e fëmijëve, interesi më i lartë është konsiderata parësore në të gjitha veprimet dhe vendimet që prekin ata. Në mënyrë të ngjashme, është prioritet i lartë të sigurohet që masat për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore të mos shkaktojnë dëm ose paragjykim ndaj atyre që synojnë të përfitojnë ose grupeve të tjera që mund të preken, si refugjatët, azilkërkuarit, emigrantët, personat e zhvendosur brenda vendit, anëtarët e pakicave dhe atyre në profesione legjitime, të cilëve mund tu shkaktohet paragjykim nga masat që synojnë të dekurajojnë ose parandalojnë TQNJ-në.

Një qasje e përqendruar te viktima do të thotë që niveli i provave që kërkohet gjatë procesit të identifikimit për të arritur në përfundimin se një individ i caktuar është trafikuar është dukshëm më i vogël se standardi i provës që kërkohet për të dënuar ata që janë përgjegjës për kryerjen e një krimi kundër këtij individ.

Një qasje e përqendruar te viktima garanton gjithashtu që viktimave të supozuara t'u ofrohen mundësi të përshtatshme për t'u rikuperuar nga përvoja e tyre e abuzimit dhe kontrollimit nga një trafikant (ose trafikantë) përpara se t'u kërkohet të ofrojnë prova për agjensitë e zbatimit të ligjit për përvojat e tyre (kjo e njohur si një periudhë 'rikuperimi dhe reflektimi'). Në rastin e shtetasve të huaj, nuk mund të ndërmerret asnjë veprim për t'i dëbuar ose për t'i zhvendosur në një vend tjetër gjatë një periudhe rikuperimi dhe reflektimi, përveç rastit kur kjo kërkohet nga vetë viktima.

Parimi 5. Ndihma E Pakushtëzuar për Viktimat

MKR-ja është e përkushtuar të sigurojë që viktimat e mundshme të trafikimit të mbrohen nga shfrytëzimi dhe dëmtimi i mëtejshëm dhe të kenë qasje në kujdesin e duhur fizik dhe psikologjik. Kuadri ligjor sqaron se mbrojtja dhe ndihma fillestare për viktimat e supozuara nuk kushtëzohen nga gatishmëria e viktimës për të denoncuar ose për të dëshmuar kundër ndonjë autori/të dyshuar të veprës penale.

Parimi 6. Përfshirja nga Dënimi

Viktimat e trafikimit nuk mund të ndalohen, akuzohen ose ndiqen penalisht për paligjshmërinë e hyrjes ose qëndrimit të tyre në vendet e tranzitit dhe destinacionit, ose për përfshirjen e tyre në aktivitete të paligjshme në masën që një përfshirje e tillë është pasojë e drejtpërdrejtë e situatës së tyre si person i trafikuar. Ndërkohë që duhen marrë masa të arsyeshme për të garantuar sigurinë e ish-viktimave të trafikimit (dhe për të ndaluar kontaktimin e tyre përsëri nga një trafikant), në parim viktimat e trafikimit nuk mund të vendosen në paraburgim për t'i parandaluar ato të kontaktojnë me trafikantin e tyre.


Parimi 7. Interesi më i Lartë i Fëmijës

Dëmi i veçantë fizik, psikologjik dhe psiko-social i pësuar nga fëmijët e trafikuar dhe rritja e ndjeshmërisë së tyre ndaj shfrytëzimit kërkon që ata të trajtohen veçmas nga viktimat e trafikimit të rritur për sa i përket ligjeve, politikave, programeve dhe ndërhyrjeve. Të gjitha veprimet dhe vendimet që prekin një fëmijë, qofshin të ndërmarra nga institucionet publike ose private të mirëqenies sociale, gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislative, duhet ta kthejnë interesin më të lartë të fëmijës në një konsideratë parësore (pra, krahas konsideratave të tjera kryesore, por jo duke renditur interesin më të lartë të fëmijës si më pak të rëndësishëm sesa konsideratat dytësore si politika e shtetit për migracionin ose nevoja për të dhënë drejtësi).

Parimi 8. Respektimi i të Drejtave të tjera të Posaçme të Fëmijëve të Trafikuar

MKR-ja përkushtohet të respektojë të gjitha të drejtat e tjera të fëmijëve në kontekstin e të gjitha nismave dhe veprimeve të saj që lidhen me fëmijët. Këtu përfshihet:

- 1. E drejta e fëmijës për të mos u ndarë nga prindërit e tij/saj kundër vullnetit të vet,** me përjashtim të rasteve kur autoritetet përkatëse përcaktojnë, në përputhje me legjisllacionin dhe procedurat në fuqi, se një ndarje e tillë është e nevojshme në interesin më të mirë të fëmijës. Një fëmijë i privuar përkohësisht ose përgjithmonë nga mjedisi i tij/saj familjar, ose për interesin më të lartë të të cilit nuk mund të lejohet të qëndrojë në atë mjedis, ka të drejtën e mbrojtjes dhe ndihmës së veçantë të ofruar nga shteti.
- 2. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar.** Çdo fëmijë që është i aftë të formojë pikëpamjet e veta ka të drejtë t'i shprehë ato pikëpamje lirisht në të gjitha çështjet që prekin fëmijën, pikëpamjeve të fëmijës iu kushtohet rëndësia e duhur (nga autoritetet ose të tjerët përgjegjës për kujdesin e fëmijës) në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës. Kjo e drejtë është veçanërisht e rëndësishme kur vendimet me ndikime afatgjata (ndonjëherë të njohura si vendime 'të qëndrueshme') merren në lidhje me një fëmijë të trafikuar, por është gjithashtu e rëndësishme kur merren vendime në lidhje me kujdesin dhe mbrojtjen e përkohshme të një fëmije.
- 3. E drejta e fëmijës për strehim dhe arsimim.** Fëmijët e pashoqëruar apo të ndarë nga familjarët duhet të kenë akomodim të sigurt i cili sigurohet drejtësdrejt nga sistemi i mbrojtjes së fëmijës në vend. Po ashtu, e drejta për arsimim, duhet t'i garantohej fëmijëve që i kanë mbijetuar trafikimit dhe pasi ka përfunduar procesi i marrjes në mbrojtje.



*** NËSE KA DYSHIME PËR MOSHËN E NJË TË RIU (D.M.TH. NËSE AI ËSHTË FËMIJË APO I RRIUR), DO TË PREZUMOHET SE AI /AJO ËSHTË FËMIJË DERISA TË PROVOHET E KUNDËRTA.**

Parimi 9. Aksesin në Drejtësi, përfshirë Dëmshpërblimin

MKR-ja është e angazhuar për të dhënë drejtësi dhe një zgjidhje efektive për viktimat e trafikimit, përfshirë edhe dëmshpërblimin e viktimave për dëmet e pësuar gjatë trafikimit.

Shteti është përgjegjës për sigurimin e mbrojtjes dhe lejeve të qëndrimit të përkohshëm për viktimat dhe dëshmitarët gjatë proceseve ligjore. Shteti siguron që viktimave të trafikimit t'u jepet akses në mjete juridike efektive dhe të përshtatshme, përfshirë dhe dëmshpërblimin.

Parimi 10. Masa për Nxitjen e Përfshirjes Sociale të Viktimave

MKR-ja është e orientuar të promovojë përfshirjen sociale të viktimave të trafikimit. Ky angazhim është një pjesë përbërëse e detyrimit të shtetit për të vepruar me kujdesin e duhur për të mbrojtur dhe ndihmuar viktimat e trafikimit dhe lidhet me të drejtën e viktimave të trafikimit për një zgjidhje efektive. Çdo person i trafikuar para se të mbushë moshën 18 vjeç ka të drejtë të bashkohet me familjen nëse dëshiron dhe në rastin e një viktime që është ende fëmijë, kjo vlerësohet si në interesin e tyre më të mirë.

Kthimi i sigurt, mundësisht vullnetar, do t'u garantohej viktimave të trafikimit si në situatat kur shtetasit shqiptarë identifikohen jashtë vendit dhe kur viktimat që janë shtetas të huaj identifikohen në Shqipëri. Kthimi do të paraprihet nga vlerësimi i rrezikut. Kthimi i mundshëm i një fëmije të trafikuar do të paraprihet gjithashtu nga një analizë dhe mbledhje informacioni social nëse parashikohet ribashkimi i fëmijës me familjen e tij/saj të origjinës.

Parimi 11. Mbrojtja e të Dhënave Personale

MKR-ja mbron jetën private dhe identitetin e viktimave. Të gjitha të dhënat personale në lidhje me një viktimë mbahen konfidenciale përveç rastit dhe derisa një viktimë e rritur të paraqitet në gjykatë për të marrë pjesë në procedurat ligjore. Në rastin e fëmijëve viktimë, identiteti i tyre nuk mund të zbulohet publikisht.

Parimi 12. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Marrëveshjet e me shtetet e tjera sigurojnë ndihmë efektive të ndërsjellë juridike në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe gjithashtu në rastet kur më shumë se disa shtetas shqiptarë dihet se janë trafikuar në një vend tjetër ose nga të cilat janë trafikuar më shumë se disa shtetas në Shqipëri. Duhet të parashikohet gjithashtu bashkëpunimi ndërkombëtar për të kërkuar mbështetje për aktivitete të jashtëzakonshme të MKR-së, që shteti nuk i ka buxhetuar (siç janë rritjet e papritura të numrit të viktimave të supozuara të trafikimit që kërkojnë mbrojtje dhe ndihmë).

III. Qasja me në qendër viktimën



Qasja me në qendër viktimën do të thotë trajtimi i viktimave të trafikimit duke iu garantuar ndihmë nga punonjës të kualifikuar dhe duke u siguruar akses të përshtatshëm në drejtësi, strehim, kujdes shëndetësor, shërbime ligjore, këshillim psiko-social, mbështetje me ndjeshmëri ndaj kulturës së vendit nga është viktimë dhe gjuhës amtare, si dhe ndihmë për qëllim të ri-integrimit në shoqëri. Kjo qasje duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë përjashtimin nga dënimi, mbrojtjen e viktimës në cilësinë dëshmitarit, periudhën e reflektimit, kompensimin dhe aksesin në drejtësi.⁶



3.1 Zbatimi i qasjes me në qendër viktimën

Qasja me në qendër viktimën është një parim themelor që qëndron në çdo aspekt të zbatimit të MKR-së për viktimat e trafikimit. Nëpërmjet zbatimit të këtij parimi, të drejtat, nevojat dhe mirëqenia e viktimës së trafikimit udhëheqin çdo veprim që lidhet me viktimën e trafikimit, duke nisur nga identifikimi fillestar i viktimës, të marrja në mbrojtje dhe asistencë, si dhe gjatë procesit penal ndaj trafikantëve të viktimës. Si e tillë, kjo përfaqësohet duhet të jetë e zbatueshme si nga punonjësit socialë, psikologët, personeli mjekësor apo inspektorët e punës që bien në kontakt me një viktimë trafikimi, po ashtu dhe nga punonjësit e policisë, prokurorët dhe gjyqtarët.

Në këtë këndvështrim, është e rëndësishme të kuptohet nga të gjithë profesionistët që zbatojnë MKR-në se çdo veprim që lidhet me viktimën e trafikimit dhe i cili duhet të ketë në qendër viktimën, siguron që te kenë përparësi dëshirat e saj, siguria, fuqizimi dhe mirëqenia e përgjithshme. Rrjedhimisht, i gjithë sistemi i identifikimit, referimit dhe mbrojtjes, përfshirë mbrojtjen gjatë procesit penal, e trajton viktimën e trafikimit me ndjeshmëri, pa paragjykim dhe duke pasur në konsideratë pozitën vulnerabël që ka viktimë e trafikimit. Nëpërmjet një ndjeshmërie të tillë dhe sistemi i drejtësisë penale duhet të synojë të minimizojë ri-traumatizimin e viktimës së trafikimit gjatë gjithë procesit penal ndaj trafikantit, ku viktimë mund të jetë dëshmitare apo pala e dëmtuar.

Viktimat e trafikimit janë një grup veçanërisht vulnerabël për disa arsye që lidhen me rrethanat specifike të tyre dhe mjetet e përdorura nga trafikantët për t'i mbajtur nën kontroll:

- **Shtrëngimi dhe kontrolli:** Trafikantët përdorin forma të ndryshme shtrëngimi dhe kontrolli, duke përfshirë dhunën fizike, kërcënimet dhe manipulimin emocional, për t'i mbajtur viktimat në situata shfrytëzuese. Kjo e bën të vështirë për viktimat që të arratisen ose të kërkojnë ndihmë.
- **Izolimi:** Viktimat e trafikimit shpesh janë të izoluara nga familja dhe miqtë, duke e bërë të vështirë të kërkojnë ndihmë ose të largohen nga trafikantët e tyre.
- **Frika nga hakmarrja:** Frika nga hakmarrja e trafikantëve nëse përpiqen të arratisen ose të denoncojnë krimin apo kërcënimet e trafikantëve se mund të hakmerren ndaj viktimës apo familjes, i mbajnë viktimat në presionin e frikës dhe i detyrojnë të heshtin.

⁶ Marrë nga Raporti Vjetor i Departamentit Amerikan të Shtetit të vitit 2017 për trafikimin e personave: <https://www.state.gov/reports/2017-trafficking-in-persons-report>


- **Statusi ligjor:** Veçanërisht viktimat migrante mund të mos kenë dokumentacion të rregullt ligjor për hyrjen apo qëndrimin në vendin ku identifikohen dhe për shkak të frikës nga dëbimi ose dënimi, nuk kërkojnë ndihmë apo e fshehin situatën ku ndodhen.
- **Statusi ligjor:** Veçanërisht viktimat migrante mund të mos kenë dokumentacion të rregullt ligjor për hyrjen apo qëndrimin në vendin ku identifikohen dhe për shkak të frikës nga dëbimi ose dënimi, nuk kërkojnë ndihmë apo e fshehin situatën ku ndodhen.
- **Trauma psikologjike:** Viktimat e trafikimit shpesh vuajnë nga trauma të rënda psikologjike si rezultat i shfrytëzimit të tyre, gjë që mund të pengojë më tej aftësinë e tyre për të kërkuar ndihmë ose për të marrë vendime racionale.
- **Varësia ekonomike:** Trafikantët shpesh shfrytëzojnë gjendjen e dobët ekonomike të viktimave, të tilla si varfëria dhe mungesa e mundësive për punë, duke e bërë akoma më të vështirë për viktimën e trafikimit të çlirohet nga trafikanti.
- **Stigmatizimi:** Viktimat mund të përballen me stigmën dhe diskriminim nga shoqëria apo dhe profesionistët që bien ndesh me viktimën, gjë që mund t'i dekurajojë ato të kërkojnë ndihmë ose të zbulojnë rrethanat e trafikimit.
- **Mungesa e ndërgjegjësimit:** Disa viktima mund të mos e kuptojnë se janë duke u trafikuar, veçanërisht në rastet e trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë, i cili ndodh në rrethana më komplekse se trafikimi për qëllim shfrytëzimin seksual.

Këta faktorë së bashku i bëjnë viktimat e trafikimit tepër vulnerabël dhe adresimi i këtyre çështjeve kërkon një qasje ndërsektoriale dhe vëmendje të veçantë ndaj **traumës së viktimës**. Që nga identifikimi fillestar dhe përgjatë të gjithë procesit të mbrojtjes, një viktimë trafikimi mund të takohet e të tregojë historinë e vet për disa profesionistë, përfshirë punonjësin social, oficerin e policisë, prokurorin apo gjyqtarin. Nisur nga detyra e gjithsecilit, viktimës do t'i kërkohej të riprodhojë historinë e vet në mënyrë që dhe profesionistët t'i japin mbështetjen e duhur. Shumë shpesh, viktimat mund të ndeshen jo vetëm me periudha të gjata pritjeje për të përfituar shërbimet për shkak të burimeve të kufizuara ose mbingarkesës së profesionistëve, por dhe me refuzimin e shërbimeve. Për profesionistët, mbingarkesa apo mungesa e trajnimeve të përshtatshme për të intervistuar viktimat e trafikimit, mund të sjellë neglizhencë apo trajtimin e rastit në mënyrë mekanike, pa i kushtuar vëmendje dëshirave apo nevojave të viktimës. Si rezultat, edhe pse personi mund të përfitojë të drejtat minimale sipas legjislacionit në fuqi, në këtë proces komunikimi mund të ndjehet e vetmuar, e trajtuar në mënyrë jo dinjitoze, e paragjykuar dhe e varur nga procesi zyrtar. Shpesh viktimat e trafikimit nuk kanë mundësi të shprehin atë që dëshirojnë ose shumë herë nuk e dinë se cilat janë të drejtat e saj pasi mund t'i shpjegohet pak informacion apo ka nevojë për më tepër kohë për të kapërcyer traumën.

Nisur nga fakti se Shqipëria ka një legjislacion gjithëpërfshirës për të adresuar trafikimin e personave si në kuadrin e legjislacionit penal dhe në atë të mbrojtjes së viktimës, përfshirë dhe një Marrëveshje për Mekanizmin Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit, zbatimi praktik i këtij legjislacioni në frymën e mbrojtjes së viktimës së trafikimit kërkon:

- **Trajnimin e vazhdueshëm** të profesionistëve që punojnë me viktimat e trafikimit.
- **Komunikimin** mes profesionistëve të ndryshëm për të siguruar jo vetëm suksesin e hetimit dhe ndjekjes penale të trafikantit, por para së gjithash mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimës.
- **Partneritetin dhe bashkëpunimin** jo vetëm brenda MKR-së por dhe me institucione shtetërore dhe jo shtetërore jashtë MKR-së, për t'iu përgjigjur kështu nevojave specifike që mund të ketë një viktimë trafikimi.

Zbatimi i këtij parimi me në qendër viktimën mund të ilustruhet si një diagramë ku në qendër të veprimeve të anëtarëve të MKR-së është viktima e trafikimit:



Për të siguruar zbatimin e kësaj përjasjeje, profesionistët e MKR-së duhet të orientohen në punën e tyre ndaj këtyre **objektivave**:

a) Siguria e viktimës së trafikimit: Siguria duhet të jetë hapi i parë për t'u përmbushur kur një profesionist përballlet me një viktimë të mundshme trafikimi. Kontakti me viktimën mund të ndodhë në faza të ndryshme të procesit të trafikimit, ndaj është parësore t'i garantohet viktimës së mundshme që të mos jetë në rrezik nga trafikantët apo nga kushtet e jetesës. Për shembull, një viktimë mund të jetë ende në kontakt me trafikantin e saj ose mund të jetojë ende me të.

b) Konfidencialiteti: Konfidencialiteti nuk lidhet vetëm me rrezikun e viktimës që të zbulohet nga trafikanti, por edhe me respektimin e personit, të të drejtave të saj/tij dhe privatësinë. Informacioni personal dhe historia e çdo personi janë jashtëzakonisht informacione që për të cilat cildo është i ndjeshëm dhe mosruajtja e informacionit mund të ketë implikime serioze për sigurinë e viktimës dhe të familjarëve.

Profesionistët duhet t'i shpjegojnë viktimës së trafikimit detyrën e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit në lidhje me viktimë, madje dhe mund ta rritet kështu dhe shpjegojnë këtë aspekt edhe gjatë ecurisë së komunikimit të vazhdueshëm me viktimën dhe sa herë që përfshihen profesionistë të rinj.

Është e rëndësishme që personi i trafikuar të dijë:

Arsyen përse kërkohej informacioni që duhet të japë:

- Si do të regjistrohet dhe ruhet informacioni;
- Si mund ta aksesojë dosjen dhe informacionin e saj;
- Identiteti i të gjithë personave dhe zyrave që mund të përdorin dhe marrin informacionin.
- Është e rëndësishme të shpjegohet, që në fillim, si do të ndahet informacioni me organizata të tjera, agjenci ligj zbatuese, ose policinë;
- Natyra e informacionit që do të ndahet me palë të tjera. Për shembull, të dhënat personale apo një pjesë e tyre apo vetëm historia pa asnjë të dhënë personale.

Pëlqimi i informuar⁷

Viktima e trafikimit duhet të japë pëlqimin e vet të mirë informuar në mënyrë që të vazhdohet me çdo shërbim apo veprim në lidhje me të. Nëpërmjet pëlqimit, viktimat e trafikimit shprehin se e kuptojnë plotësisht situatën ku ndodhet, të drejtat e veta, ligjin që i shpjegohet si dhe vetëdijen për pasojat e veprimeve nëse ndërmerr veprime konkrete. Dhënia e pëlqimit duhet të vijë si rezultat i komunikimit të kujdesshëm, që mban parasysh traumën që ka kaluar viktimat dhe duke i dhënë mbështetjen dhe kohën e nevojshme për të marrë vendime për të përvetësuar informacionin dhe për të bërë pyetje.

Standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale përcaktojnë hapat që duhet të ndërmarrin ofruesit e shërbimeve për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave personale të përfituesve, duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale dhe të kujdesshme. Nëpërmjet një sërë veprimesh të pasqyruara në standarde, ofruesit e shërbimeve garantojnë menaxhimin e të dhënave sipas normave ligjore dhe bazuar në parimin e ruajtjes së konfidencialitetit.

c) Mosdiskriminimi:

Koncepti i diskriminimit

“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në lidhje me *racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.⁸

Viktimat e trafikimit mund të përballen me diskriminim brenda komunitetit ku jetojnë ose punojnë dhe diskriminimi mund të ndodhë për shkak të *racës, gjinisë, etnisë, kulturës, fesë, orientimit seksual, situatës së dobët social-ekonomike, situatës së borxhit dhe/ose përfshirjes në aktivitete kriminale, ushtrimit të prostitucionit apo përdorimit të substancave dhe varësia prej tyre*.

Për shkak të këtyre faktorëve, personat e trafikuar mund të ndeshen me pengesa në aksesin ndaj të drejtave dhe shërbimeve si në përballjen me agjencitë ligj zbatuese apo organet e drejtësisë por dhe në aksesin në shërbime shëndetësore apo në shkolim e punësim.



3.2 Qasja me në qendër viktimën në procesin penal ndaj trafikantit

Është e pamundur që trafikimi i qenieve njerëzore të luftohet në mënyrë efektive pa një mbrojtje të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar. Edhe nga këndvështrimi i drejtësisë penale, personat e trafikuar duhet të jenë në qendër të veprimeve kundër trafikimit, pikërisht sepse janë viktimat të një shkeljeje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Asistenca që u jepet viktimave duhet të synojë **rehabilitimin dhe përfshirjen e tyre sociale. Nga perspektiva e hetimit, qasja e bazuar tek të drejtat e njeriut kërkon që personat e trafikuar të mos procedohen penalisht për asnjë vepër penale që mund të lidhet me statusin e tyre.**

Përveç kësaj, duhet të mbahet parasysh se mosofrimi i mbrojtjes dhe asistencës së duhur mund të pengojë bashkëpunimin e personave të trafikuar, mund t'i bëjë ata më vulnerabël ndaj trafikantëve madje mund t'i çojë drejt një situatë e paqëndrueshme emocionale, psikologjike duke u kthyer në shënjestra të lehta nga personat

⁷ National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook – Second Edition [Mekanizmi Kombëtar I Referimit – Bashkimi I përpjekjeve për të Mbrojtur të Drejtat e Personave të Trafikuar: Manual Praktik, Edicioni I Dytë]. OSBE, Janar 2022: https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/510551_2.pdf

⁸ Sipas Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

e akuzuar. Efikasiteti i hetimit dhe procedimit të veprave penale të trafikimit lidhet fort me vullnetin e personit të trafikuar për të bashkëpunuar. Ky vullnet varet shpesh nga mbrojtja që i ofrohet për sigurinë dhe privatësinë e personit dhe familjes, si dhe nga kujdesi dhe trajtimi me respekt nga të gjitha autoritetet ligjzbatuese e gjyqësore. Po kështu, vullneti i bashkëpunuesit i viktimës mund të cenohet nga rreziku i riadhesimit dhe/ose arrestimi apo ndjekja penale për vepra penale që lidhen me emigrimin e paligjshëm apo me përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

Përveç kësaj, qasja e përqendruar tek respektimi i të drejtave të njeriut kërkon një analizë të fenomenit në lidhje me llojin e viktimës. Çdo viktimë ka historinë e vet. Gjinia, kombësia, rolet tradicionale që u caktojnë grave në shoqëri të ndryshme, praktikat diskriminuese të llojeve të ndryshme që i përkasin një vendi apo një grupi të caktuar janë të rëndësishme për t'u vlerësuar. Politikat aktuale kundër trafikimit kanë veçanërisht në vëmendje gratë e shfrytëzuara seksualisht, por po aq i mprehtë është situata e burrave, fëmijëve apo dhe grave në fusha të tjera të shfrytëzimit. Në çdo rast aksesin në sistemin e mbrojtjes apo dhe për të marrë lejen e qëndrimit, nuk duhet të kushtëzohet nga bashkëpunimi i viktimave të trafikimit duhet me autoritetet kompetente gjatë procedimit penal për të pasur; kjo është kundërproduktive për luftën kundër trafikimit dhe të drejtat e njeriut⁹.

Me qëllim respektimin e plotë të të drejtave të njeriut të personave të trafikuar dhe për t'u dhënë atyre mundësi që të rindërtojnë jetën e tyre, shtetet duhet të zbatojnë në mënyrë korrekte dispozitat ligjore për t'u dhënë atyre një periudhë reflektimi, e cila nuk duhet të kushtëzohet me bashkëpunimin me autoritetet. Eksperienca në disa vende, statistika dhe vlerësime të kohëve të fundit tregojnë qartë se dhënia e lejes së qëndrimit viktimave, të cilat për arsye të ndryshme nuk janë të gatshme ose nuk kanë vullnetin të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente – kryesisht nga frika e hakmarrjes ndaj familjeve të tyre – rrit ndjeshëm jo vetëm numrin e viktimave, por edhe efikasitetin e luftës kundër trafikimit. Mundësia për përfshirje sociale afatgjatë është një prej komponentëve më të rëndësishëm të fuqizimit të viktimave, bashkë me aksesin në drejtësi dhe zgjidhjet ligjore që përfshijnë edhe dëmshpërblimin.¹⁰

Zbatimi i instrumenteve të mira të identifikimit, asistencës dhe mbrojtjes së viktimave ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në efikasitetin e hetimeve dhe kapacitetin e viktimave për të bashkëpunuar me autoritete të besueshme të zbatimit të ligjit.

⁹ “Trafikimi i qenieve njerëzore - Manual për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të tjerë të drejtësisë”, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2021. <https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/512644>

¹⁰ Raporti i 3-të i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi progresin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020) në zbatim të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third_progress_report.pdf

IV. Qasja e përqendruar tek kujdesi dhe ndjeshmëria ndaj traumës



Të gjithë anëtarët e MKR-së duhet të respektojnë qasjen dhe parimin e ndjeshmerise ndaj traumës (*parimin e informuar per traumën*).

Sipas këtij parimi, anëtarët e MKR duhet të njohin dhe pranojnë ndikimin e gjerë dhe të shtrirë në kohë të traumës dhe kuptojnë rrugët e mundshme për rimëkëmbje. Gjithashtu ata duhet të njohin shenjat dhe simptomat e traumës tek klientët, familjet, stafi dhe të gjithë individët e tjerë të përfshirë dhe përgjigjen duke i integruar plotësisht njohuritë rreth traumës në politikat, procedurat dhe praktikat e tyre, duke u përpjekur maksimalisht të shmangin ritraumatizimin.

Sipas këtij parimi, theksohet siguria fizike, psikologjike dhe emocionale si për viktimat ashtu edhe për profesionistët/ofruesit e shërbimeve, gjë që lejon viktimat për të rindërtuar një ndjenjë sigurie, kontrolli dhe fuqizimi.

Përdorimi i parimit të ndjeshmërisë ndaj traumës së viktimës shmang praktikat dhe proceset institucionale që ka të ngjarë të çojnë në ri-traumatizim të individëve me histori të traumës dhe lejon që shërbimet të ofrohen në atë mënyrë që lehtëson pjesëmarrjen e vetë viktimave. Ky parim i shikon viktimat si ekspertë të nevojave të tyre.¹¹

Qëllimet e qasjes së informuar për traumën janë:

- Reduktimi i ri-traumatizimit
- Theksimi i pikave të forta dhe aftësisë ripërtëritëse të të mbijetuarve
- Promovimi i shërimit dhe rigjenerimit;
- Mbështetja e zhvillimit të mekanizmave të shëndetshëm të përballimit afatshkurtër dhe afatgjatë

Një qasje e përqendruar tek ndjeshmëria ndaj traumës fillon me kuptimin e ndikimit fizik, shoqëror dhe emocional të traumës mbi individin, si dhe mbi profesionistët që i ndihmojnë ata. Kjo përfshin praktika të përqendruara te viktimat.

Ajo përfshin tri elementë:

1. Të kuptojë mbizotërimin e traumave.
2. Njohja se si trauma prek të gjithë individët e përfshirë në program, organizatë/institucion, ose sistem, duke përfshirë fuqinë e saj punëtore.
3. Përgjigja duke vënë në praktikë këtë njohuri.

Ashtu si në qasjen me në qendër viktimat, përparësi merr siguria dhe mbrojtja nga politikat dhe praktikat që pa dashje mund t'i traumatizojnë viktimat.

¹¹ SAMHSA's Concept of Trauma and Guidance for a Trauma-Informed Approach [Koncepti i SAMHSA-së për Traumën dhe Udhëzimet për një Qasje të Informuar nga Trauma]: https://ncsacw.acf.hhs.gov/userfiles/files/SAMHSA_Trauma.pdf

Ndërsa përvoja e traumave të secilit individ mund të jetë e ndryshme, është e rëndësishme të kuptohet se si ajo mund të ndikojë burimet përballuese të individit dhe të çojë në fillimin e strategjive të mbijetesës të drejtuara biologjikisht. Trauma mund të jetë rezultat i një ngjarjeje të vetme (fatkeqësi natyrore, dëshmimi ose përjetimi i një akti të dhunshëm) ose një sërë peripecish (abuzimi afatgjatë).

Shumica e situatave të trafikimit janë kulmimi i shumë përvojave traumatike, shumica e të cilave janë të patrajtuara.

Trauma ndikon në mënyrën se si:

- Viktimat e shohin veten ("Unë jam i pafuqishëm", "i pavlefshëm")
- Pikëpamjen e tyre të botës ("Bota është e rrezikshme, askush nuk mund të më mbrojë")
- Marrëdhëniet ("Unë nuk mund t'i besoj askujt")

Këto besime ndikojnë në mënyrën se si viktimat reagojnë ndaj institucioneve dhe profesionistëve që i ndihmojnë, dhe nënvizojnë rëndësinë që institucione të zbatojnë një qasje që tregon ndjeshmëri dhe kujdes ndaj traumave.

4.1 Zbatimi i qasjes së përqendruar tek kujdesi ndaj traumës¹²



Parimet kryesore për të zbatuar qasjen që tregon ndjeshmëri ndaj traumës janë:

1. **Siguria**
2. **Besueshmëria dhe Transparenca**
3. **Mbështetja nga të mbijetuarat/klientët të tjerë**
4. **Bashkëpunimi dhe reciprociteti**
5. **Fuqizimi, zëri dhe zgjedhja**
6. **Konsiderimi i çështjeve kulturore, historike dhe gjinore**



¹² (Bazuar në Zyrën e Përgatitjes dhe Reagimit të Shëndetit Publik dhe Qendra Kombëtare për Kujdesin e Informuar për Traumën: <https://www.samhsa.gov/find-help/disaster-distress-helpline/coping-tips>)

Siguria

Të mbijetuarit e traumave siç janë edhe viktimat e trafikimit duhet të ndjehen të sigurt fizikisht dhe psikologjikisht, kështu që të gjithë profesionistët duhet të kujdesen për sigurinë fizike të viktimave, por edhe që ndërveprimet ndërpersonale të nxisin një ndjenjë sigurie.

- Ofroni/krijoni një ambient mikpritës.
- Jini të ndjeshëm ndaj shkaktarëve që mund t'i kujtojnë viktimave të trafikimit traumat e kaluara.
- Mos i bëni presion viktimës së trafikimit për t'iu përgjigjur pyetjeve nëse heziton.
- Ji i sjellshëm. Viktimat e mundshme të trafikimit mund të jenë luftarake ose armiqësore. Përvojat e tyre të jetës dhe traumat e kaluara e bëjnë të vështirë besimin e ofruesve të kujdesit ose njerëzve me autoritet.

Besueshmëria dhe Transparenca

Sigurohuni që të gjitha veprimet dhe vendimet të kryhet me transparencë me qëllim ndërtimin dhe ruajtjen e besimit me viktimat e trafikimit

- Mbani kufijtë e duhur profesional.
- Sqaroni rolin tuaj.
- Merrni pëlqimin e informuar.
- Jini të qëndrueshëm/konsistent. Duhet kohë për të krijuar besim.

Mbështetja nga të mbijetuara/përfitues të tjerë të shërbimeve

Inkurajimi i të mbijetuarve të traumës për t'u përfshirë në vetë-ndihmë reciproke

- Angazhoni bashkëmoshatarët me ndjeshmëri, respekt dhe mbështetje.
- Ofroni mundësi domethënëse për kolegët për të lehtësuar, organizuar dhe koordinuar aktivitetet.
- Punësoni të mbijetuar me aftësi të përshtatshme për të mentoruar të mbijetuarit e tjerë ose për të ofruar programim nga kolegët.

Bashkëpunimi dhe reciprociteti

- Maksimizimi i mundësive për bashkëpunim dhe ndarje të pushtetit midis stafit me të mbijetuarit.
- Pranoni se të gjithë kanë një rol për të luajtur në kujdesin e informuar për traumat. Nuk duhet të jesh një terapist për të qenë terapeutik.

Fuqizimi, zëri dhe zgjedhja

- Lejoni viktimat e trafikimit dhe stafin të ndajnë përvojat e tyre dhe të bëjnë pyetje sipas nevojës.
- Jini transparent në shpjegimin e opsioneve dhe rolit tuaj.
- Respektoni vendimet që marrin viktimat e trafikimit, edhe nëse nuk jeni dakord.

Konsiderimi i çështjeve kulturore, historike dhe gjinore

Njohja e traumës historike të shkaktuar ndaj individëve bazuar në kulturë, racë/etni, gjini dhe identitete të tjera të marginalizuara

- Siguroni materiale të përkthyer dhe përkthyes të kualifikuar për viktimat e trafikimit sipas nevojës.
- Respektoni identitetin dhe praktikat kulturore.
- Njihni dhe trajtoni traumën e shkuar.

Këshilla për ndërtimin dhe përdorimin e një qasje që tregon ndjeshmëri dhe kujdes ndaj traumës¹³

- Rishikoni politikat dhe procedurat e institucionit për të identifikuar dhe hequr çdo gjë që është potencialisht e pasigurt dhe e dëmshme për viktimat e trafikimit me histori traumash.
- Siguroni formimin dhe trajnimin e stafit, duke përfshirë ata që punojnë drejtpërdrejt me viktimat e trafikimit si dhe ofruesit e tjerë në sistemet përkatëse të kujdesit.
- Vlerësoni për mundësinë e traumës në ambiente të ndryshme.
- Siguroni sigurinë dhe plotësoni nevojat bazë të shërbimit.
- Ndërtoni marrëdhënie afatgjata, mbështetëse dhe ofroni mundësi për rritimin e roleve të vlerësuara shoqërore.
- Ofroni qasje në shërbimet e trajtimit të traumave specifike.
- Specifike për adoleshentët, përdorni terapinë në grup për të trajtuar zhvillimin e aftësive, të ndikojë në rregullimin, lidhjet ndërpersonale, dhe aftësinë dhe ndërtimin e resiliencës.
- Kuptoni rolin që kultura luan në rimëkëmbje dhe rëndësinë e burimeve të komunitetit si potencialisht ndikuese në përvojën traumatike, veçanërisht për viktimat e huaja.
- Bëjini të disponueshme modelet dhe mbështetjet e bashkëmoshatarëve.
- Angazhoni të mbijetuarit në programim.
- Zhvilloni alternativa për terapi të tradicionale.



4.2 Udhëzime për profesionistët

Udhëzimet për profesionistët në qasjen e informuar për traumat ndryshojnë, por komponentët kryesorë përfshijnë:

- Njohja e treguesve dhe simptomave të traumës;
- Kuptimi i ndikimit të traumës tek të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore;
- Sigurimi i pushimit/pauzave të përshtatshme në çdo takim apo angazhim me të mbijetuarit;

¹³ "Treating the Hidden Wounds: Trauma Treatment & Mental Health Recovery for Victims of Human Trafficking", Heather J. Claëson, Ph.D., Amy Salomon, Ph.D., and Lisa Goldblatt Grace, LICSE, MPH. [Trajtimi i plagëve të fshehura: Trajtimi i Traumës dhe Rikuperimi i Shëndetit Mendor për Viktimat e Trafikimit, Heather J. Clawson, Ph.D., Amy Salomon, Ph.D., dhe Lisa Goldblatt Grace, LICSW, MPH: <https://www.ovcttac.gov/taskforceguide/eguide/4-supporting-victims/41-using-a-trauma-informed-approach/>]

- Respektimi i konfidencialitetit, privatësisë dhe pëlqimit të informuar;
- Menaxhimi i të dhënave me kujdes;
- Marrja e një qasjeje të ndjeshme gjinore dhe kulturore;
- Sigurimi i një perspektive dhe reagimi me dhembshur/kujdes dhe empati
- Respektimi i natyrës individuale të përvojës dhe këndvështrimit personal të të mbijetuarve;
- Kuptimi i barazisë, autonomisë, njohurive dhe fuqive të të mbijetuarve; dhe

Sigurimi i komunikimeve të ndjeshme dhe të përshtatshme. Qasja e informuar për traumën e vë theksin në bashkëpunimin me të mbijetuarit/mbijetuarat për të krijuar zgjidhje të përcaktuara dhe ideuara prej tyre. Gjithashtu njihet gjithnjë e më shumë se punësimi i të mbijetuarve lider në mënyrë profesionale në të gjithë spektrin e sektorëve të antitrafikimit promovon adoptimin e një qasjeje të bazuar tek viktimat dhe të mbijetuarit, të informuar nga trauma dhe të bazuara në të drejtat e njeriut.

Të kuptuarit e ndikimit të traumës nga trafikimi i qenieve njerëzore¹⁴



“ TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE ËSHTË NJË SHKELJE E INTEGRITETIT INDIVIDUAL, NJË KËRCËNIM PËR EKZISTENCËN DHE PËR RRJEDHOJË NJË BURIM I TRAUMAVE KRONIKE NDERPERSONALE. ¹⁵ ”

Të mbijetuarit përshkruajnë se kanë duruar nivele të larta fatkeqësish dhe traumash, si dhe humbje të shumta dhe kërcënime për sigurinë e tyre. Të rriturit dhe fëmijët janë shpesh në shënjestër të trafikantëve, sepse ata kanë një kombinim të faktorëve të vulnerabilitetit dhe kështu mund të kenë përjetuar tashmë një nivel traume. Këto dobësi mund të lidhen me moshën/nivelin e tyre të jetës

përvoja, sfondi familjar ose komuniteti, kushtet shëndetësore, lëndimet, paaftësitë, varësia nga substancat, statusin e pasigurt të migracionit, ose një krizë në rrethanat ose situatën e tyre personale. Prandaj, në shumë raste, përvoja e trafikimit përkeqëson dhe shton vulnerabilitetin dhe përvojat traumatike ekzistuese.

Gjatë trafikimit të qenieve njerëzore, të mbijetuarit kanë përjetuar marrëdhënie të shtrembëruara dhe degraduese njerëzore. Shpesh, janë detyruar në situata të varësisë totale nga ata që i trafikojnë dhe abuzojnë me to për javë, muaj ose vite, pa mundur t'i besojnë askujt apo të kërkojnë ndihmë. Është e zakonshme që të mbijetuarit e trafikimit të përshkruajnë ndjenja e frikës nga besimi te viktimat e tjera pasi trafikantët mund t'i manipulojnë viktimat për t'i kundërvënë ndaj njëra-tjetrës për t'i mbajtur në gjendje frike nëse viktimat përpiqen ndonjëherë të kërkojnë ndihmë ose të shpëtojnë.

Të qenurit i/e trafikuar për çdo formë shfrytëzimi është një përvojë e frikshme, e vetmuar dhe

izoluese; viktimat mund të humbasin ndjenjën e identitetit personal së bashku me çdo besim në vlerën e lidhjeve pozitive me njerëzit e tjerë. Mashtrimi, abuzimi, tradhtia dhe dhuna e ushtruar nga trafikantët shpesh ka një ndikim afatgjatë në jetën e të mbijetuarve dhe shumë prej tyre vazhdojnë të jetojnë nën frikën e kërcënimeve ndaj trafikantëve për vete, familjet dhe të dashurit e tyre.

Procesi afatgjatë i rimëkëmbjes nga trafikimi dhe rindërtimi i jetëve është zakonisht i gjatë, kompleks dhe i vështirë; shumë prej tyre nuk do ta arrijnë kurrë atë.

¹⁴ OSCE/ODIHR, Guidance on Trauma Informed National Referral Mechanism and Response to Human Trafficking, 2023 [OSBE/ODIHR, Udhëzim mbi MKR-në e informuar mbi traumën dhe përgjigjen ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2023]: <https://www.osce.org/odihr/549793>

¹⁵ Siân Oram and Jill Domoney, Responding to the mental health needs of trafficked women. Healthcare, Counselling and Psychotherapy Journal [Siân Oram dhe Jill Domoney Trajtimi i nevojave të shëndetit mendor të grave të trafikuar. Gazeta e kujdesit shëndetësor, këshillimit dhe psikoterapisë]: <https://www.bacp.co.uk/bacp-journals/healthcare-counselling-and-psychotherapy-journal/april-2018/responding-to-the-mental-health-needs-of-trafficked-women/>

Besimi

Është jetike që viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit të qenieve njerëzore të jenë në gjendje t'u besojnë shërbimeve dhe programeve të krijuara për t'i mbrojtur ato, si dhe secilit prej profesionistëve që punojnë me ta, si individualisht ashtu edhe brenda ekipeve. Ky është një komponent thelbësor i MKR-ve efektive dhe funksionale. MKR-të efektive me shumë agjenci kanë nevojë për një sjellje kohezive dhe komunikime të informuara për traumat nga të gjithë profesionistët, agjencitë dhe shërbimet, për të siguruar që korniza të jetë e kuptueshme, gjithëpërfshirëse dhe mikpritëse për viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit. Është gjithnjë e më e qartë se qasja informuar për traumën nuk është thelbësore vetëm për mirëqenien dhe sigurinë e të mbijetuarve, por edhe për profesionistët e vijës së parë të cilët duhet të punojnë në mënyrë efektive, duke shmangur traumat dytësore dhe konsumimin profesional.

Organizatat dhe agjencitë e palëve të interesuara, duke filluar nga organizatat e shoqërisë civile te autoritetet kombëtare, konstatojnë se cilësia e punës së tyre profesionale varet nga aftësia e tyre për të ndërtuar dhe mbajtur marrëdhënie besimi me të mbijetuarit për të siguruar kontakt të vazhdueshëm dhe angazhim me shërbimet. Prandaj, profesionistët që vijnë në kontakt me viktimat

dhe të mbijetuarit e trafikimit gjatë çdo aspekti të punës së tyre duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të jenë në gjendje të njohin ndikimi i traumës dhe duhet të trajnohen në metodat e punës të informuara për traumat/që tregojnë ndjeshmëri për traumat.

V. Mbrojtja e posaçme e fëmijëve viktima të trafikimit



Çdo veprim që ka lidhje me fëmijën e trafikuar apo në rrezik trafikimi duhet të udhëhiqet nga parimet e të drejtave të fëmijës. Masat për mbrojtjen e fëmijëve dhe ato posaçërisht për mbrojtjen e fëmijëve viktima të trafikimit dhe të shfrytëzimit bazohen në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, të reflektuara në legjislacionin shqiptar dhe veçanërisht në Ligjin 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Këto parime i gjejmë të reflektuara dhe në procedurat që rregullojnë bashkëpunimin ndërinstitucional në fushën e anti-trafikimit.



5.1 Interesi më i lartë i fëmijës

Parimi i parë dhe kryesor është ai i “**interesit më të lartë të fëmijës**”. Çdo veprim i kryer ndaj një fëmije trafikuar apo në tërësi veprimtaria në kuadrin e masave kundër trafikimit të fëmijëve, duhet të udhëhiqet nga parimi i “*interesit më të lartë*” të fëmijës, si parimi kryesor kundrejt të cilit duhet konsideruar çdo vendimmarrje në lidhje me fëmijën.

Në ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ky parim spikat në një nen të posaçëm, duke marrë kështu një vlerë të veçantë në raport me parime të tjera mbi të cilat realizohet mbrojtja e fëmijës. Ligji bën dhe një shtjellim të hollësishëm të interesit më të lartë të fëmijës, duke parashikuar se zbatimi i këtij parimi është i detyrueshëm si në nivel hartimi dhe zbatimi të legjislacionit dhe në nivel trajtimi rasti individual, nga cdo institucion publik e jopublik dhe nga gjykatat.

Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh:

- nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje;
- mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen;
- aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirëritjen e fëmijës për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore dhe/ose shpirtërore.¹⁶

¹⁶ Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, neni 6.

Mosdiskriminimi

Parim i dytë i rëndësishëm është ai i mbrojtjes nga diskriminimi, i cili merr një rëndësi të vecantë në kontekstin e mbrojtjes së fëmijës së trafikuar, veçanërisht në rastet e fëmijëve që u përkasin pakicave dhe fëmijëve migrantë. Këta të fundit gëzojnë të njëjtat të drejta si fëmijët shqiptarë përsa kohë identifikohen për mbrojtje brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky parim i rëndësishëm mishërohet dhe në Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, fusha e zbatimit të së cilit, krahas fëmijëve me shtetësi shqiptare, përfshin dhe fëmijët pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, që ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë¹⁷.

Respektimi i mendimit të fëmijës

Parimi i tretë lidhet me të drejtën e fëmijës për të marrë pjesë, për t’u dëgjuar dhe për t’iu respektuar mendimi gjatë procesit të mbrojtjes. Institucionet publike dhe jopublike që trajtojnë një fëmijë të trafikuar duhet të marrin vendime që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e fëmijës. Në varësi të moshës dhe aftësisë për të kuptuar, fëmija jep mendimin e vet në lidhje me masat mbrojtëse, ku mund të përfshihet dhe mendimi për të qëndruar ose jo me prindërit¹⁸, vendimi për t’u kthyer ose jo në vendin e origjinës në rastin e fëmijëve që ndodhen jashtë vendit të origjinës jo domosdoshmërisht si viktima trafikimi.

Legjislacioni shqiptar parashikon se për vendosjen e masave të mbrojtjes ndaj fëmijës që ka mbushur moshën 14 vjeç, është e detyrueshme të merret pëlqimi i vetë fëmijës. Në rast se fëmija nuk jep pëlqimin, atëherë marrja e masës së mbrojtjes merret nga drejtori i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore, vendim, i cili është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi gjyqësor nga gjykata për lënien në fuqi, kur për këtë masë përkatëse parashikohet shqyrtimi gjyqësor¹⁹.

Parimet e tjera që udhëheqin zbatimin e cdo veprimi që lidhet me fëmijët janë:

- ✓ Parimi i jetës
- ✓ Rritja në një mjedis të përshtatshëm familjar
- ✓ Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit
- ✓ E drejta për informacion
- ✓ E drejta e ruajtjes së konfidencialitetit
- ✓ E drejta për të qenë i mbrojtur



5.2 Interesi më i lartë i fëmijës gjatë procesit të identifikimit

Një prej aspekteve kryesore të parimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në çështjet e trafikimit është **identifikimi i shpejtë dhe i saktë i tyre si viktima të trafikimit dhe sigurimi i mbrojtjes së menjëhershme**. Identifikimi i një fëmije si viktimë e mundshme e trafikimit ose viktimë e trafikimit është një proces i gjatë dhe kompleks për shkak të natyrës komplekse që ka ky krim dhe ndërveprimi të disa personave. Identifikimi mund të bëhet nga strukturat e policisë, punonjësit socialë, etj, bazuar në një sërë treguesish, si në rastin e të rriturve dhe procedurash zyrtare si përsa i përket identifikimit dhe referimit të rastit. Proces i identifikimit bazohet në treguesit e trafikimit, të cilët janë elemente përshtatshme të procesit të trafikimit dhe reflektojnë paraqitjen e efekteve/pasojave të trafikimit tek i mituri.

Treguesit e trafikimit në vetvete nuk janë prova se trafikimi është kryer si vepër penale, por konsiderohen si pikënisje për hetime të trafikimit. Treguesit e trafikimit i shërbejnë kryesisht strukturave që kanë ballafaqimin e parë me një viktimë të mundshme trafikimi dhe duhet t’i zbërthejnë këta tregues për të kryer identifikimin e një

¹⁷ Id. neni 4.

¹⁸ Id. neni 9.

¹⁹ Id. neni 59.

viktime trafikimi dhe/ose për të nisur hetimin e rastit. Njohja me treguesit e trafikimit dhe procesin e identifikimit fillestar të viktimës së trafikimit mund t'i shërbejë punonjësve të sistemit të drejtësisë për të kryer veprime më të thelluara në lidhje me çështjen dhe nëse përbën një rast trafikimi.

Komunikimi me fëmijët

Fëmijët kanë të drejtë të dëgjohen dhe të marrin pjesë në vendimet që i prekin ata. Të gjitha vendimet në lidhje me fëmijët, duhet të merren gjithmonë duke patur në plan të parë të drejtat dhe interesin e tyre më të lartë. Shpjegimi i dhënë fëmijëve, duhet të jetë i përshtatshëm për moshën, të informuar për traumat dhe të përqendrohen te të drejtat e fëmijës.

Pjesëmarrja e informuar e fëmijëve viktime të trafikimit, duhet të garantojë përfshirjen e fëmijës në të gjitha fazat dhe vendimet për ta. Duhet mbajtur shënime opinionet dhe pikëpamjet e fëmijës gjatë gjithë kohës. Fëmijëve duhet t'u sigurohet informacion dhe materiale për të drejtat e tyre të përshtatshme për moshën dhe fëmijën. Ata duhet të informohen për të drejtën e tyre për të marrë pjesë dhe për të bërë pyetje për të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ta.

Në të gjitha veprimet dhe komunikimet me fëmijët, të drejtat e tyre specifike dhe interesat më të larta duhet të jenë prioriteti kryesor. Përgjigjet e të rriturve ndaj çdo fëmije që është në një situatë vulnerabël mund të kenë një efekt të qëndrueshëm mbi ta, prandaj qëndrimet e të gjithë aktorëve të MKR-së ndaj fëmijëve janë jashtëzakonisht domethënëse: ata mund t'i inkurajojnë ose t'i pengojnë ata të qëndrojnë në kontakt me shërbimet.

Një përgjigje e përshtatshme, jo ndërhyrëse dhe e kujdesshme ndaj çdo fëmije që mund të jetë viktimë e trafikimit është thelbësore për krijimin e besimit që në fillim. Kjo e ndihmon fëmijën të ketë besim te sistemet dhe profesionistët që janë aty për t'i mbrojtur ata. Përgjigjet pozitive, miqësore dhe të përshtatshme për moshën nga të rriturit, janë veçanërisht mbështetëse për fëmijët që mund të kenë vështirësi të mëdha për t'u besuar të rriturve. Qëllimi duhet të jetë që të ndihmohen fëmijët të njohin një qasje të ndjeshme dhe të sjellshme, e cila tregon shqetësim për sigurinë dhe mirëqenien e tyre të menjëhershme.



5.3 Interesi më i lartë i fëmijës gjatë procedimit penal


Interesi më i lartë i fëmijës prevalon mbi balancimin e interesave të procesit të drejtësisë, identifikimin dhe sjelljen e trafikantëve para drejtësisë. Siguria e fëmijës nuk duhet të vihet asnjëherë në rrezik nga veprimet e organeve të zbatimit të ligjit dhe statusi i fëmijës si viktimë duhet të garantohet e pëmbushet.

Fëmijët nuk duhet në asnjë rast të diskriminohen për shkak të statusit të tyre ligjor në vendin ku realizohet procesi i drejtësisë, shtetësisë, natyrës së veprës penale, etj.

Udhëzimi i posacëm i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për garantimin e ndihmës për viktimat dhe dëshmitarët e krimeve”, nr. 05, datë 26.10.2018.

Sipas nenit 15 të Udhëzimit prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë janë të detyruar nga ligji dhe udhëzimi të identifikojnë viktimat e krimit, t'i njoftojnë për të drejtat dhe t'u ofrojnë asistencën e përshkruar në këtë udhëzim duke mbajtur parasysh gjithsesi se viktimat nuk është e detyruar t'i ushtrojë të drejtat e saj apo ta pranojë këtë asistencë dhe mund të zgjedhë, në çdo fazë të procedimit penal, të refuzojë marrjen e asistencës ose ushtrimin e të drejtave.

VI. Faktorët e vulnerabilitetit që lidhen me përkatësinë gjinore të viktimave të trafikimit



Ndërgjegjësimi për faktorët që rrisin cënueshmërinë e viktimave ndaj trafikimit është thelbësor në zhvillimin dhe zbatimin e masave parandaluese dhe të mbrojtjes²⁰. Njohja e këtyre faktorëve nga profesionistët e të gjitha disiplinave dhe trajtimi me ndjeshmëri e tyre, bën të mundur një trajtim më efikas dhe sipas nevojave specifike të viktimave të trafikimit. Disa nga faktorët e rrezikut që ndikojnë në trafikimin e individëve janë përkatësia gjinore dhe mosha e tyre. Nga raportimet e ndryshme ndërkombetare dhe vendse rezultojnë se, vajzat janë më të rrezikuara ndaj trafikimit krahasuar me djemtë, pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre gjinore, për më tepër, rreziku i trafikimit të tyre shtohet:

- Nëse familjet e tyre kanë probleme sociale.
- Nëse janë rritur në kujdestari apo kanë një histori të qenit subjekt i dhunës fizike, psikologjike apo seksuale.
- Nëse kanë një histori të përjetimit të dhunës fizike, psikologjike apo seksuale.
- Varfëria, niveli i ulët i të ardhurave, paqëndrueshmëria financiare, rezultojnë faktorë rreziku për trafikimin e individëve, pavarësisht gjinisë, pra, si për gratë, ashtu edhe për burrat.



6.1 Pabarazitë gjinore

Diskriminimi gjinor, dhuna me bazë gjinore, dhuna në familje, prekin në mënyrë jo proporcionale gratë dhe vajzat, duke i bërë ato më vulnerabël e më të cënueshme ndaj trafikimit.

Diskriminimi gjinor për shkak të barrierave strukturore dhe pabarazive gjinore ekzistuese, është një faktor i rëndësishëm që ndikon në rritjen e rrezikshmërisë së trafikimit të grave dhe vajzave. Për ta ilustruar, mund të përmendim se pjesëmarrja e plotë e grave në tregun e punës, ndikohet nga qasja e pabarabartë në arsim dhe kualifikim, diskriminimi në rekrutim, si edhe barra e pabarabartë e përgjegjësisë shtëpiake dhe e kujdesit për fëmijët. Si rezultat i pabarazive të tilla gjinore, statusi socio-ekonomik dhe ligjor i grave dhe vajzave është më i ulët në krahasim me statusin që gëzojnë burrat dhe djemtë në shoqëri.

Për këtë arsye, Komiteti i OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) ka rekomanduar që shtetet të forcojnë shërbimet publike në fushat që mbështesin arritjen e barazisë gjinore, të promovojnë të drejtat e grave dhe vajzave si të drejta njerëzore, si dhe të mbështesin zhvillimin ekonomik e social gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm, në mënyrë që të reduktojnë rrezikun e faktorëve ndikues në trafikimin e individëve.

²⁰ Applying Gender-Sensitive Approaches in Combating Trafficking in Human Beings. OSCE Office of the Special Representative and Co-ordinator for Combating Trafficking in Human Beings, Applying gender-sensitive approaches in combating trafficking in human beings (Vienna, 2021). [Zbatimi i qasjes së ndjeshme ndaj gjinisë në masat kundër trafikimit të Genieve Njerëzore. OSBE, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Masat kundër Trafikimit të Genieve Njerëzore (Vjenë, 2021)]: <https://www.osce.org/cthb/486700>

Përveç diskriminimit gjinor në sferën ekonomike dhe sociale, ekspozimi ndaj dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës ndaj grave (qënia viktimë apo dhe dëshmitar/e), ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cënueshmërisë së grave dhe vajzave ndaj trafikimit.

Duhet mbajtur parasysh se pabarazitë gjinore, të bazuara dhe në paragjykimet dhe stereotipet gjinore kanë një ndikim të madh në zhvillimin socio-ekonomik dhe në shoqërinë në tërësi. Stereotipet e forta gjinore sa i përket maskulinitetit, rolin të burrave në familje dhe në shoqëri, ndikojnë negativisht edhe te burrat dhe djemtë. Vështirësitë financiare dhe problemet ekonomike të familjeve, në të cilat burrat priten të sigurojnë të ardhurat kryesore, veçanërisht në kohë krizash, mbetet një faktor rreziku madhor, që djemtë apo burrat të bien pre e trafikimit.


Interseksionaliteti

Burrat dhe gratë, djemtë e vajzat, nuk janë të ekspozuar në të njëjtën masë apo dhe ndaj të njëjtëve faktorëve risku të trafikimit të qenieve njerëzore. Cënueshmëria e tyre është subjekt i faktorëve të ndryshëm që ndërthuren me njëri-tjetrin, si mosha, kombësia, niveli i aftësive, përkatësia etnike dhe statusi socio-ekonomik. Për të qenë sa më efikasë në përpjekjet për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, është thelbësore që profesionistët e të gjitha disiplinave, jo vetëm të njohin e kuptojnë natyrën gjinore të formave specifike të shfrytëzimit, por edhe faktorët e tjerë që ndërthuren dhe rrisin vulnerabilitetin e individëve për tu kthyer në viktimat trafiki. Konkretisht, veç përkatësisë gjinore dhe moshës, qënia pjesë e një minoriteti, niveli i aftësive, niveli i të ardhurave në familje, ndërthuren duke rritur cënueshmërinë e individit. Ndërlidhja ndërmjet këtyre faktorëve të rrezikut del në pah dhe është veçanërisht e dukshme në rastet e individëve që i përkasin minoriteteve. Margjinalizimi dhe diskriminimi ndaj këtyre pakicave, janë faktorë të qartë të cënueshmërisë që mund të çojnë në trafikim. Ndaj, profesionistët që kontribuojnë në parandalimin e trafikimit apo ofrimin e shërbimeve sociale ndaj viktimave të trafikimit, duhet të njohin dhe kuptojnë ndërlidhjen mes faktorëve të riskut.

Patriarkalizmi

Përveç formave të përhapura të pabarazisë gjinore dhe faktorëve ndërsektorialë, patriarkalizmi luan një rol vendimtar në shkeljen e të drejtave, dhunimin apo shfrytëzimin sistematik të grave dhe vajzave. Pabarazitë gjinore në shtresa të ndryshme sociale, kudo në botë, i vendosin gratë dhe vajzat në status më të ulët që i bëjnë gratë dhe vajzat të ndjeshme ndaj trafikimit për punë ose shfrytëzim seksual. Normat gjinore shoqërore, mbi të cilat bazohen pabarazitë ekzistuese gjinore kontribuojnë më tej në specifikat gjinore të trafikimit.

Gratë dhe vajzat vuajnë në mënyrë jo proporcionale nga objektivizimi dhe trafikimi për qëllime të shfrytëzimit seksual. Megjithatë, nuk janë vetëm gratë dhe vajzat që vuajnë si viktimat të pabarazive gjinore; burrat dhe djemtë janë gjithashtu të prekur nga nocionet shoqërore të bazuara në sistemet patriarkale. Për shkak të pritshmërive patriarkale në lidhje me punën dhe gjininë, të rinjtë dhe djemtë janë shpesh nën presion për të siguruar të ardhurat për familjet e tyre. Hulumtimet e fundit kanë treguar se, megjithëse djemtë dhe të rinjtë emigrantë janë veçanërisht të rrezikuar nga trafikimi për shfrytëzim seksual, ky rrezik konsiderohet më i ulët se ai i vajzave, për shkak të normave social-kulturore.



6.2 Pabarazitë gjinore dhe trafikimi i qenieve njerëzore

Pabarazia gjinore, së bashku me pabarazitë e tjera, rrit rrezikun e trafikimit të grave dhe vajzave. **Pasiguria ekonomike, mungesa e opsioneve të qëndrueshme të punësimit dhe varfëria** janë përcaktuar si faktorë që kontribuojnë në cënueshmërinë ndaj trafikimit. Dëshpërimi dhe mungesa e shpresës së grave dhe vajzave për të përmirësuar kushtet e tyre ekonomike, shfrytëzohet veçanërisht nga trafikantët në fazat e rekrutimit dhe shfrytëzimit të viktimave. Në familjet me të ardhura të ulëta, faktorë të tillë si **aksesi i pabarabartë i vajzave në arsim** dhe përfundimi i arsimit, mund të kontribuojnë në trafikimin e vajzave dhe grave të reja, si një mënyrë për familjet për të gjeneruar të ardhura dhe pasuri. **Mungesa e aksesit** në mbrojtjen sociale **të përgjegjshme gjinore**, është gjithashtu një faktor që rrit rrezikun e varfërisë dhe cënueshmërisë së grave ndaj trafikimit.

Në fillim të **pandemisë Covid 19** në 2020, hulumtimi tregoi se gratë dhe vajzat e trafikuar përjetuan pengesa më të mëdha për të aksesuar shërbimet mbështetëse. Të dhënat për dënimet dhe ndjekjet penale të trafikantëve nga viti 2020, tregojnë një rënie të tyre, për herë të parë që nga viti 2003. Kjo e dhënë potencialisht tregon se trafikimi i grave dhe vajzave nuk ka qenë prioritet gjatë periudhës së rikuperimit të pandemisë dhe pas izolimit. Duhet mbajtur parasysh se pandemia e COVID-19 ka ndikuar në mënyrë jo të barabartë tek gratë dhe vajzat krahasuar me djemtë e burrat, ka rritur vulnerabilitetin e tyre ndaj trafikimit, veçanërisht për shkak të ndikimeve gjinore ekonomike dhe sociale të pandemisë. Gratë kanë vuajtur barrën e humbjes së mjeteve të jetesës për shkak të pandemisë. Stresi ekonomik rrit vulnerabilitetin e grave dhe vajzave ndaj trafikimit²¹.

Ndryshimi i klimës është tjetër një krizë me zhvillim të shpejtë dhe e vazhdueshme në të gjithë botën, me ndikime shkatërruese në jetesën, mirëqenien dhe sigurinë e individëve e komuniteteve, veçanërisht të më të margjinalizuarve. Ndryshimi i klimës është një shumëzues rreziku për pabarazitë gjinore, për shkak të ndikimeve të tij thellësisht gjinore. Dëshmitë sugjerojnë se duke ndikuar në mjetet e jetesës, duke rritur varfërinë dhe duke shkaktuar zhvendosje të detyruar, degradimi i mjedisit dhe thatësitat mund të cojnë gjithashtu në rritjen e rasteve të dhunës ndaj grave. Përveç përqendrimit të pabarazive gjinore, ndryshimet klimatike gjithashtu intensifikojnë faktorët më të gjerë të rrezikut për trafikimin, veçanërisht pasi njerëzit kanë më shumë gjasa të zgjedhin rrugët e rrezikshme të migrimit. Edhe pse ekziston një rrezik në rritje i trafikimit dhe shfrytëzimit për të gjithë njerëzit e zhvendosur, gratë dhe vajzat migrante, në veçanti, janë shpesh në shënjestër të dhunës, ngacmimit, abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual dhe të punës²².

Konfliktet e vazhdueshme, të reja dhe në përshkallëzim, po rezultojnë në një valë krizash në mbarë botën. Lidhja ndërmjet konfliktit dhe trafikimit të grave dhe vajzave është vërtetuar ndër vite. Rritja e varfërisë dhe mundësitë e kufizuara ekonomike, janë faktorë që kontribuojnë në trafikimin e grave dhe vajzave dhe që përqësohen në situata konflikti. Në veçanti, rritja e shpejtë e personave të zhvendosur dhe pa shtetësi, rrit cënueshmërinë ekonomike të grave dhe vajzave dhe rrezikun e tyre për trafikim dhe shfrytëzim. Pasiguria ekonomike dhe fizike i vendos gratë dhe vajzat në situata të dëshpëruara, ku ato kanë më shumë gjasa të ndjekin mundësi të rrezikshme ose të mashtrohen nga trafikantë për një jetë më të mirë. Konflikti gjithashtu rrit kërkesën për mallra dhe shërbime të ofruara nga personat e shfrytëzuar dhe krijon kërkesa të reja për role shfrytëzuese luftarake dhe mbështetëse. Ekzistojnë gjithashtu dobësi specifike gjinore në kontekstet e konfliktit që rrisin rrezikun e trafikimit për gratë dhe vajzat, veçanërisht rritjen e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin.



6.3 Një qasje e ndjeshme gjinore për viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit

Një qasje e ndjeshme gjinore për shërbimet ndaj viktimave dhe të mbijetuarave të trafikimit, është thelbësore për të siguruar një funksionim efikas të MKR-së, që ka në qendër viktimën. Nga raportimet rezulton se gratë dhe vajzat vazhdojnë të përbëjnë shumicën e rasteve të trafikimit, veçanërisht për qëllime shfrytëzimi seksual. Pikërisht për të garantuar një Mekanizëm sa më funksional kërkohet njohja, kuptimi dhe adresimi i nevojave specifike të grave dhe vajzave, si dhe të të gjitha viktimave dhe të mbijetuarave të trafikimit.

Vetëm në rast se procedurat dhe shërbimet e MKR-së do të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë, si dhe të bazohen në një politikë dhe strategji kombëtare, për të adresuar dinamikën gjinore të trafikimit të qenieve njerëzor do të sigurohet një mbrojtje dhe trajtim profesional dhe që i përgjigjet nevojave të viktimës. Kjo qasje e ndjeshme gjinore, duhet të jetë pjesë përbërëse e trajtimit të viktimave të trafikimit përgjatë 4 Shtyllave të MKR-së: Identifikimi plus Mbrojtja; Mbështetja individuale dhe aksesit në shërbime; Përfshirja Sociale; Drejtësia penale dhe dëmtshpërblimi.

21 "Trafficking in women and girls: crises as a risk multiplier Report of the Secretary-General", UN (2022). [Trafikimi i grave dhe vajzave, kriza si shumëfishim i riskut. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm", OKB (2022)]: <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-10/A-77-292-SG-report-Trafficking-en.pdf>

22 Id.

Identifikimi me ndjeshmëri gjinore i viktimave të trafikimit

Identifikimi është një proces formal, përmes të cilit një grua, burrë, vajzë apo djalë, vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet nëse ai/ajo mund të jetë viktimë e mundshme e trafikimit dhe cilat janë nevojat e saj/të tij immediate, me qëllim referimin për të përfutur shërbimet e duhura. Për këtë arsye, është gjithmonë më mirë të identifikohet si viktimë në një fazë sa më të hershme, me qëllim që të parandalohet dëmi.

Paragjykimet dhe stereotipet gjinore i bëjnë disa profile të viktimave dhe forma të trafikimit më pak të dukshme. Mungesa e njohurive dhe metodave për t'u marrë me grupe specifike, pengon punën cilësore të parandalimit dhe zbulimit të rasteve. Prandaj, është thelbësore të rriten njohuritë e aktorëve që punojnë kundër trafikimit, duke rritur aftësitë e tyre për të identifikuar profilet e ndryshme të viktimave dhe për t'u përgjigjur në mënyrë adekuate nevojave të të gjitha viktimave, qofshin gra apo burra, në përputhje me detyrimet dhe angazhimet e institucioneve përgjegjëse.

Për të kuptuar më mirë dimensionet gjinore dhe moshore të trafikimit për shfrytëzim seksual, është e rëndësishme **që të mblidhen të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe moshës së viktimave dhe autorëve. Për më tepër, është e domosdoshme që të dhënat e mbledhura për viktimat të përfshijnë informacione për mbështetjen, ndihmën dhe masat mbrojtëse që janë zbatuar.** Duke marrë parasysh rëndësinë e treguesve në identifikimin e viktimave, duhet që treguesit specifikë gjinorë të informuar nga provat në lidhje me rreziqet dhe nevojat specifike gjinore të përjetuara nga viktimat e trafikimit për shfrytëzim seksual, të jenë pjesë integrale e procesit të identifikimit. Mekanizmat e identifikimit duhet të marrin parasysh rrethanat e veçanta dhe nevojat specifike gjinore të fëmijëve viktimat të trafikimit për shfrytëzim seksual, duke përfshirë specialistë për trajtimin e fëmijëve të abuzuar.

Komunikimi i ndjeshëm gjinor me viktimat

Intervista me viktimat e trafikimit duhet të zhvillohet gjithmonë në një hapësirë të sigurt dhe të rehatshme, ku viktimat të ndihet e sigurtë, të ketë privatësi, si edhe të mos shqetësohet gjatë intervistës. I gjithë komunikimi me të mbijetuarit/at, duhet të kryhet nga profesionistë me njohuri dhe shprehje komunikimi empatik, të informuar për traumën dhe impaktin e saj, me gjuhë etike dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, si dhe të përshtatshme me moshën dhe kulturën e viktimës. Është thelbësore që viktimat dhe të mbijetuarit/at e trafikimit, të marrin informacion dhe një shpjegim të qartë të identitetit dhe rolit të secilit profesionist që punon me ta, si edhe qëllimin e pranisë së tyre aty. Dhënia e informacionit është një hap i rëndësishëm në proces për t'i mundësuar viktimës të ndihet sa më e sigurt. Është gjithashtu hapi i parë drejt ndërtimit të një marrëdhënieje besimi midis viktimës dhe aktorëve të përfshirë.

Komunikimet dhe sjellja me ndjeshmëri gjinore, janë jetike për të siguruar që të mbijetuarit/at të ndihen sa më të sigurtë, të mbrojtur, të besuar, të paparagjykuar dhe të ndihmuar. Të mbijetuarit/at nuk duhet të ndihen kurrë të kërcënuar ose të shpërfillur për ndonjë arsye që lidhet me gjininë apo përkatësinë e tyre etnike. Komunikimi duhet të jetë etik, jodiskriminues, pa paragjykim gjinor, stigma apo stereotipe.

Komunikimi i qartë dhe efektiv është detyra e parë e çdo profesionisti që punon me të mbijetuarit e trafikimit. Përshtypjet e para janë thelbësore për vazhdimësinë e mbështetjes: të mbijetuarit që përjetojnë një përgjigje fillestare pozitive dhe qetësuese nga profesionistët kanë shumë më tepër gjasa të kthehen ose të kërkojnë ndihmë nëse më vonë humbasin kontaktin. Komunikimi pozitiv përfshin respektimin e detyrës së konfidencialitetit dhe pëlqimin e informuar. Kjo u mundëson profesionistëve dhe të mbijetuarve të ndërtojnë një marrëdhënie besimi, e cila mund t'i mbështesë të mbijetuarit të zbulojnë më shumë për historitë e tyre të trafikimit dhe nevojat dhe rreziqet e tyre²³.

Për të inkurajuar identifikimin, rekomandohet që të gjitha intervistat me viktimat të kryhen në një mënyrë që merr në konsideratë qasjen gjinore. Si e tillë, zgjedhja e gjinisë së intervistuesit duhet t'u ofrohet natyrisht të gjitha viktimave dhe gjatë të gjitha intervistave.

23 National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook – Second Edition [Mekanizmi Kombëtar i Referimit – Bashkimi i përpjekjeve për të Mbrojtur të Drejtat e Personave të Trafikuar: Manual Praktik, Edicioni I Dytë]. OSBE, Janar 2022

Karakteristikat kryesore të një interviste të ndjeshme gjinore janë, se ajo:

- Kryhet nga një intervistues i gjinisë së zgjedhur të të intervistuarit dhe minimizon rrezikun e dëmtimit dytësor ndaj viktimave për shembull.
- Duke minimizuar numrin e intervistave që viktimat duhet të japin, apo dhe ndjesitë negative që mund të kenë ndaj gjinisë së intervistuesit/es, që mund t' i ritraumatizojë ato.
- Mbajtja e viktimës në çdo kohë të informuar për atë që do të ndodhë, në një mënyrë që të mund ta kuptojnë plotësisht (p.sh. në një gjuhë në të cilën ajo mund të komunikojë dhe në një stil që është i kuptueshëm për të, sipas arsimimit dhe prejardhjes së saj kulturore).
- Është gjithashtu thelbësore përfshirja e viktimës në të gjitha vendimet për hapat e mëtejshëm, duke vazhduar vetëm me pëlqimin e saj të plotë²⁴.



6.4 Shërbime me ndjeshmëri gjinore për viktimat

Të gjithë viktimat e trafikimit (gra dhe vajza, burra dhe djem) ndajnë të njëjtat nevoja themelore - të jenë të sigurtë dhe të mbrojtur, të kuptohen dhe të pranohen. Gjinia dhe karakteristikat e tjera individuale që lidhen me përvojën e trafikimit, ndikojnë në mënyrën se si këto nevoja do të manifestohen, komunikohen dhe plotësohen. Për këtë arsye, kur vlerësohen nevojat e viktimave, është e rëndësishme që gjithmonë të vëzhgohet viktimat si individ dhe profesionistët të jenë të vetëdijshëm për stereotipet dhe paragjykimet gjinore dhe t'i shmangin ose ti adresojnë ato sa më shumë që të jetë e mundur. Megjithatë, është e nevojshme të kihet parasysh se disa nevoja janë të lidhura me gjininë, siç janë nevojat shëndetësore, të cilat mund të ndryshojnë ndjeshëm sipas gjinisë dhe formës së shfrytëzimit (për shembull, nevojat e shëndetit seksual dhe riprodhues të grave).

Është shumë e rëndësishme të punohet për zhvillimin e shërbimeve të specializuara për viktimat e trafikimit, gra apo burra, vajza apo djem, në vend që të përpiqemi t'i përshtatim viktimat sipas shërbimeve ekzistuese të krijuara për përfitues të tjerë. Këto shërbime duhet të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë, t'i përgjigjen nevojave specifike të viktimave dhe mjaftueshëm fleksibël në mënyrë që të jenë efektive.

Ofrimi i shërbimeve të specializuara për viktimat e trafikimit duhet të përqendrohet në nevojat e viktimave, moshën dhe duhet të jetë specifike për gjininë, si dhe specifike për formën e trafikimit që viktimat ka përjetuar. Këto shërbime ofrohen më së miri nga organizata që mund të përfshijnë viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit, ekspertët gjinorë në vendimmarrjen e tyre, si edhe që kanë financim të qëndrueshëm.

Profesionistët duhet t'i japin përparësi parandalimit të viktimizimit dytësor dhe gjatë procedimit penal ndaj trafikantit. Kjo mund të bëhet përmes përdorimit të një qasjeje konfidenciale dhe specifike gjinore që përfshin, por nuk kufizohet në: shmangien e përsëritjes së panevojshme të intervistave gjatë hetimit, ndjekjes penale ose gjyqimit, parandalimin e kontaktit vizual ndërmjet viktimave dhe të pandehurve, sigurimin që nuk ka pyetje të panevojshme në lidhje me jetën private të viktimës, heqja e kërkesës për paraqitjen e viktimës në gjykatë, mbledhja e dëshmive/seancave dëgjimore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së komunikimit ose regjistrimeve, marrja e masave të veçanta në trajtimin dhe ruajtjen e të dhënave²⁵.

Thelbësore për ruajtjen e sigurisë së grave dhe vajzave, është të kuptuarit e natyrës gjinore të trafikimit të grave dhe vajzave, shkaqet dhe pasojat e tij, dhe ofrimi i shërbimeve brenda një kulture të fuqizimit të grave dhe vajzave.

24 "Gender-specific measures in anti-trafficking actions", EIGE, 2018. ["Masat e orientuara drejt gjinisë", EIGE, 2018]: https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/gender-specific-measures-anti-trafficking-actions-report?language_content_entity=en

25 European Institute for Gender Equality. Gender-specific measures in anti-trafficking, 2018 [Instituti Evropian për Barazinë Gjinore, Masat me ndjeshmëri gjinore në anti-trafikim, 2018]: actions https://docs.euromedwomen.foundation/files/ermef-documents/8349_4.303.gender-specificmeasuresinanti-traffickingactions.pdf

Kjo përfshin qasjen që shërbimet të jenë të përqendruara te gratë, miqësore ndaj fëmijëve, të mos fajësojnë viktimat e trafikimit, si edhe të mbështesin gratë dhe fëmijët që të marrin në konsideratë gamën e zgjedhjeve që kanë, duke mbështetur vendimet e tyre.

Një konsideratë e veçantë nevojitet gjithashtu në rastin e fëmijëve në ofrimin e mbrojtjes dhe mbështetjes duke përfshirë autoritetet përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimin e masave specifike mbrojtëse.

- Shërbimet duhet të jenë:
- Të informuar për traumën: njohjen e ndikimit të traumës dhe të promovojnë mjedise shërimi dhe rikuperimi.
- Të ndjeshëm ndaj viktimës: jepni përparësi dëshirave, sigurisë dhe mirëqenies së viktimës në të gjitha çështjet dhe procedurat.
- Miqësore për fëmijët: hartoni dhe zbatoni masa duke pasur parasysh nevojat, interesat, sigurinë dhe interesat më të larta të fëmijës.
- Të ndjeshëm ndaj gjinisë: trajtojini të gjitha viktimat me respekt të barabartë pavarësisht nga identiteti i tyre gjinor, duke shmangur stereotipet ose supozimet në bazë gjinore.
- Kulturalisht e përshtatshme: merr parasysh dhe respekton bindjet, vlerat, normat, praktikat dhe gjuhën kulturore dhe fetare të viktimës.

Ofruesit e shërbimeve mund të eksplorojnë opsionet e disponueshme me të mbijetuarin dhe t'i lejojnë ata të zgjedhin se cilat shërbime do të donin të përdornin. Mbrojtja dhe mbështetja duhet të jenë vullnetare, konfidenciale, jodiskriminuese, jogjyquese dhe në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut. Shërbimet duhet të jenë mjaft fleksibël për të përmbushur nevojat dhe interesat specifike të viktimave të ndryshme të të gjitha formave të trafikimit.

Përvojat e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat e trafikimit²⁶

- Frika dhe rreziku i dëmtimit
- Ndjenjat dhe reagimet gjatë mbrojtjes dhe mbështetjes
- Mbrojtja dhe mbështetja që ofrohet nuk është ajo çfarë duan apo kanë nevojë viktimat
- Viktimat nuk kuptojnë mbrojtjen dhe mbështetjen që ofrohet
- Barrierat gjuhësore dhe kulturore



6.5 Ndërgjegjësimi për ndikimin e dhunës me bazë gjinore

Profesionistët duhet të jenë të vetëdijshëm se të mbijetuarit/at e trafikimit për çdo formë shfrytëzimi mund të kenë histori të dhunës seksuale që mund t'i bëjë ata të ndihen të frenuar, të turpëruar dhe të stigmatizuar²⁷. Gratë dhe vajzat përfaqësojnë shumicën dërrmuese të viktimave të identifikuar që trafikohen për shfrytëzim seksual dhe ato zakonisht vuajnë dhunën seksuale brenda formave të tjera të shfrytëzimit dhe në procesin e trafikimit. Burrat dhe djemtë

²⁶ "Trafficking Victim Protection and Support: A Practitioner Guide", NEXUS Institute Surtees, Rebecca and Laura S. Johnson (2021) ["Mbrojtja e Viktimës së Trafikimit dhe Mbështetja: Udhëzues për Profesionistë", Instituti NEXUS, Surtees, Rebecca dhe Laura S. Johnson (2021)]. <https://nexusinstitute.net/wp-content/uploads/2021/05/Trafficking-Victim-Protection-and-Support.-A-Practitioner-Guide-NEXUS-and-RSO-2021-1.pdf>

²⁷ National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook – Second Edition [Mekanizmi Kombëtar i Referimit – Bashkimi i përpjekjeve për të Mbrojtur të Drejtat e Personave të Trafikuar: Manual Praktik, Edicioni I Dytë]. OSBE, Janar 2022

gjithashtu trafikohen për shfrytëzim seksual, dhe shumë prej tyre kanë përjetuar dhunë seksuale dhe forma të tjera shfrytëzimi dhe në proces trafikimi. Si për gratë, ashtu edhe për burrat dhuna seksuale konsiderohet akoma tabu dhe e kanë të vështirë të flasin për të. Në shumë raste, dhuna seksuale nuk zbulohet, ose zbulohet me vështirësi të mëdha për shkak të turpit dhe frikës së përjetuar nga viktimat.

- **Viktimat dhe të mbijetuarit/at duhet të jenë në gjendje të zgjedhin gjininë e profesionistëve që punojnë me ta në çdo rol që konsiston në regjistrimin ose diskutimin e detajeve personale ose informacioneve të ndjeshme.** Viktimat e çdo gjinie mund të preferojnë të punojnë me gra profesioniste, kështu që këto gratë profesioniste duhet të jenë të pjesë e ekipeve multidisiplinore. Në rastin e trajtimit të fëmijëve, gratë profesioniste të specializuara për trajtimin e fëmijëve, duhet të jenë patjetër në dispozicion.
- **Profesionistët gjatë vlerësimit të nevojave duhet të sigurohen që të kuptojnë ndikimin e përvojave të dhunës me bazë gjinore tek të mbijetuarit.** Kjo duhet të merret në konsideratë kur profesionistët janë duke komunikuar për të marrë versionin e të mbijetuarit ose për të kryer një vlerësim të të rriturve ose fëmijëve dhe kur hartojnë planin e tyre të vazhdueshëm të sigurisë.
- **Të mbijetuarit/at duhet të kenë mundësi** dhe t'u jepet kohë e mjaftueshme për t'u dëgjuar dhe për t'u kuptuar në lidhje me nevojat, problematikat, si edhe mundësitë e tyre për të marrë vendime.

VII. Pjesëmarrja e të mbijetuarave të trafikimit në MKR



7.1 Rëndësia e Pjesëmarrjes së të Mbijetuarve në MKR

Të mbijetuarit e trafikimit janë në qendër të MKR-së. Ata kanë përvojë të jetuar, njohuri dhe informacion për metodat dhe aktivitetet e trafikantëve, së bashku me një kuptim të pakrahasueshëm të nevojave individuale të të mbijetuarve dhe reziqeve specifike me të cilat ata përballen.

Sot janë zhvilluar mjaft praktika pozitive që të mbijetuar të trafikimit janë themelues të OJF-ve dhe bizneseve, konsulentë, ofrues trajnimesh, folës publikë, autorë dhe avokatë në të gjithë sektorët qeveritarë, shoqërinë civile dhe private. Ato ofrojnë dëshmi për rastet e trafikimit dhe përvojën e tyre me sistemin e drejtësisë dhe atë mbrojtjes sociale, menaxhojnë OJF-të, ofrojnë shërbime dhe libra autorësh, raporte dhe dokumente të tjera mbi trafikimin e qenieve njerëzore. Ata janë avokatë, gjyqtarë, politikëbërës, profesionistë të kujdesit shëndetësor, punonjës socialë, themelues të bamirësisë dhe artistë. Shumë të mbijetuar janë ofrues shërbimesh dhe ndërmjetës kulturorë, duke dhënë ekspertizën dhe njohuritë e tyre në përmbushjen e nevojave komplekse të viktimave.

Prania e vazhdueshme e të mbijetuarve në MKR, mbështet të gjithë anëtarërt e tjerë për të kuptuar më mirë krimin e trafikimit dhe mënyrën e plotësimit të nevojave të viktimave dhe të mbijetuarve. Gjithashtu ndihmon për të zbutur stigmën rreth trafikimit, për të rritur ndërgjegjësimin për krimin e trafikimit dhe për të zhvilluar strategji efektive të parandalimit dhe reagimit ndaj trafikimit.²⁸

Në kontekstin e MKR-së, pjesëmarrja e viktimave të trafikimit është thelbësore për disa arsye:

- **Sigurimi i të Drejtave të Njeriut:** Lejimi i viktimave për të marrë pjesë aktive në procesin e MKR-së mbështet të drejtat e tyre themelore të njeriut. Ai i fuqizon ata të kenë një fjalë në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre.
- **Qasje e informuar për traumën:** Viktimat e trafikimit shpesh përjetojnë trauma të rënda. Përfshirja e tyre në procesin e MKR-së mund të ndihmojë në mbështetjen e një qasjeje të informuar për traumat, duke marrë parasysh nevojat dhe përvojat e tyre unike.
- **Fuqizimi dhe autonomia:** Pjesëmarrja u jep viktimave një ndjenjë të lirisë dhe kontrollit mbi jetën e tyre. Ai i ndihmon ata të rifitojnë një ndjenjë autonomie, e cila shpesh humbet gjatë përvojës së trafikimit.
- **Mbledhja e informacionit gjithëpërfshirës:** Viktimat kanë njohuri të dorës së parë për përvojat e tyre të trafikimit, duke përfshirë detaje rreth trafikantëve të tyre, metodat e përdorura dhe kushtet që kanë duruar. Kontributi i tyre është i paçmuar për autoritetet që të ndërtojnë raste të forta kundër trafikantëve.

- **Mbështetje e përshtatur nevojave specifike:** Viktimat janë në pozitën më të mirë për të komunikuar nevojat dhe preferencat e tyre imediate. Udhëzuesit e tyre të të dhënave mbështesin organizatat në ofrimin e shërbimeve që janë më të dobishme për rikuperimin e tyre.
- **Parandalimi i ritrafikimit:** Viktimat shpesh kanë njohuri të vlefshme për rrjetet dhe metodat e përdorura nga trafikantët. Bashkëpunimi i tyre është thelbësor në parandalimin e ri-trafikimit dhe çmontimin e rrjeteve të trafikimit.
- **Ndërtimi i besimit:** Përfshirja e viktimave në procesin e MKR-së ndihmon në ndërtimin e besimit midis tyre dhe autoriteteve. Ky besim është thelbësor për bashkëpunimin e tyre në procedurat ligjore dhe gatishmërinë e tyre për të aksesuar shërbimet mbështetëse.
- **Sigurimi i rezultateve:** Pjesëmarrja e viktimave ndihmon për të siguruar që vendimet e marra brenda procesit të MKR-së janë të drejta dhe në përputhje me interesat e tyre më të mira.
- **Përmirësimi i politikave dhe programeve:** Reagimet nga viktimat mund të informojnë zhvillimin dhe përmirësimin e politikave dhe programeve që synojnë luftimin e trafikimit. Ndihmon në identifikimin e boshllëqeve në sistem dhe fushat ku shërbimet mund të përmirësohen.

Në përmbledhje, përfshirja e viktimave të trafikimit në Mekanizmin Kombëtar të Referimit është jo vetëm një domosdoshmëri etike, por edhe praktike për identifikimin, mbështetjen dhe ndjekjen efektive të trafikantëve. Kjo qasje respekton dinjitetin dhe të drejtat e viktimave, duke forcuar gjithashtu përpjekjet e përgjithshme kundër trafikimit në vend.

Shqipëria është një **shembull pozitiv** në përfshirjen e të mbijetuarve të trafikimit nëpërmjet krijimit dhe mbështetjes së Bordit Këshillimor të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Në vitin 2019, Koordinatori Kombëtar dhe Koalicioni i Strehëzave Anti-trafik nënshkruan Marrëveshjen për Krijimin dhe Funksionimin e Bordit Këshillimor për Viktimat e Mundshme/Viktimat e të Trafikimit. Qëllimi i Marrëveshjes është:

- Themelimi dhe funksionimi i Bordit Këshillimor.
- Rritja e partneritetit antitrafik ndërmjet institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile.
- Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm koordinues ndërmjet aktorëve antitrafik, përfshirë shoqërinë civile.
- Rritja e përfaqësimit të viktimave të trafikimit në të gjitha fazat e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave dhe programeve për parandalimin e qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave.
- Krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm koordinues ndërmjet aktorëve antitrafik, përfshirë shoqërinë civile.
- Rritja e përfaqësimit të viktimave të trafikimit në të gjitha fazat e vendimmarrjes dhe hartimit të politikave dhe programeve për parandalimin e qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave.

Bordi Këshillimor i Viktimave të trafikimit është një mekanizëm gjithëpërfshirës këshillues me një rol aktiv të të mbijetuarve të trafikimit që janë ri-integruar ose në proces ri-integrimi.

Bordi ka hartuar dokumentin e Rregullores së tij të brendshme. Dokumenti rendit detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit, strukturën organizative, funksionimin e një Sekretariati Teknik, përcakton organizimin e mbledhjeve të Bordit, trajton çështjet e konfidencialitetit dhe etikës dhe vendos rregullat për menaxhimin e të dhënave personale.

28 National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook – Second Edition [Mekanizmi Kombëtar i Referimit – Bashkimi i përpjekjeve për të Mbrojtur të Drejtat e Personave të Trafikuar: Manual Praktik, Edicioni I Dytë]. OSBE, Janar 2022: https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/510551_2.pdf

Më 30 maj 2019, u krijua zyrtarisht **Bordi Këshillimor për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit**. Anëtarët e Bordit janë të mbijetuar të fuqizuar të cilët vullnetarisht kontribuojnë në veprimet e Bordit Këshillimor. Aktualisht bordi përbëhet nga tre anëtarë, përfitues të programeve të qendrave anëtare. *Gjithësesi Bordi ka nevojë të fuqizohet dhe të rritet konsultimi i anëtarëve të MKR me Bordin Këshillimor.*

Marrëveshja për MKR-në e firmosur në qershor 2023, parashikon për herë të parë dhe këshillimin me të mbijetuarit e trafikimit nëpërmjet **Bordit Këshillimor të Viktimave të Trafikimit**.



7.2 Konsiderata në lidhje me përfshirjen e të mbijetuarave/mbijetuarve

Disa konsiderata të rëndësishme për t'u marrë parasysh nga anëtarët e MKR-së për përfshirjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit janë:

Siguria në Pjesëmarrje

- Pjesëmarrja dhe përfaqësimi duhet që në rradhë të parë të jenë të sigurta. **Është e rëndësishme** që profesionistët/anëtarët e MKR:²⁹
- Të zhvillojnë dhe të përdorin mjete të matjes së rrezikut;
- Të ketë një protokoll pjesëmarrjeje të sigurt për aktivitetet që të ndiqet në mënyrë strikte;
- Të sigurojë transport të sigurt;
- Të ketë marrëveshje me ofrues sigurie për ndërhyrje në rast rreziku;
- Të ketë dhe të zbatohet në mënyrë strikte një protokoll për dokumentimin e pjesëmarrjes që të përcaktojë masat për mënjanimin e rrezikut.

Vullneti i lirë në pjesëmarrje

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi duhet të jetë me vullnet të lirë. Profesionistët duhet të mbajnë parasysh se shpesh, edhe pse nuk e shprehin, të mbijetuarit mund të ndjehen të detyruar të marrin pjesë në aktivitete sepse mund ta konsiderojnë këtë si një mënyrë të shprehjes së mirënjohjes së tyre për ndihmën e marrë. Vullneti për pjesëmarrje mund të shprehet me shkrim ose me gojë. Është e rëndësishme që vullneti i lirë për pjesëmarrje të ekzistojë përgjatë gjithë aktivitetit, dhe të mbijetuarit të kuptojnë se mund të tërhiqen në çdo kohë pa u ndier keq.

Ruajtja e konfidencialitetit në pjesëmarrje

Ruajtja e konfidencialitetit është një çështje sigurie por edhe etike. Është e rëndësishme që përpara se të vendoset për pjesëmarrje dhe përfaqësim të të mbijetuarave, të shqyrtohen të gjitha rreziqet e shkeljes së konfidencialitetit nga të gjitha palët dhe të bihet dakord për masat që do të merren për ruajtjen e konfidencialitetit.

Lehtësimi profesional i punës në grup të të mbijetuarve.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi është i lidhur ngushtësisht me lehtësimin e grupeve. Profesionistët që lehtësojnë grupet duhet që të mbajnë parasysh që:

- Lehtësuesit duhet ta trajtojnë sigurinë dhe mirëqenien e të mbijetuarve si primare dhe shumëdimensionale, fizike, psikologjike, si dhe të vlerësuar rast pas rasti;
- Lehtësuesit duhet të kenë njohuri për punën në grup, fazat e zhvillimit të grupit, dinamikat në grup;

29 Bazuar në Udhëzuesin "Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi i Viktimave të Trafikimit", Të Ndryshëm & Të Barabartë" 2022": <https://differentandequal.org/sq/pjesemarrja-dhe-perfaqesimi-i-viktimave-te-trafikimit/>

- Lehtësuesit duhet të njohin shenjat/simptomat e traumës, efektet që kanë ngjarjet traumatike, shenjat e ritraumatizimit dhe duhet të marrin masa për të shmangur ritraumatizimin.

Koha e gjatë që kërkohet për pjesëmarrje.

Sigurimi i pjesëmarrjes efektive të të mbijetuarve në punën anti-trafik është një ndërmarrje e cila kërkon kohë. Profesionistët duhet të jenë të gatshëm për të shpenzuar kohë për:

- informimin e qartë dhe të saktë lidhur me aktivitetet, rolet që individët do të kenë, rreziqet dhe pasojat pozitive dhe negative;
- akomodimin e orareve të punës, studimit, kujdesit për fëmijët;
- shërimin e traumave;
- përballimin e situatave të papritura sociale, shëndetësore, ekonomike.

Trajtimi i përshtatshëm në Media

Trajtimi i pjesëmarrjes nga media mund të ketë një efekt dëmtes jo vetëm mbi pjesëmarrjen por edhe mbi vetë mbrojtjen e përfituesve. Për të siguruar një mbështetje të pjesëmarrjes dhe përfaqësimit nga media është e nevojshme që të punohet paraprakisht me median. Puna paraprake me pjesëmarrje të përfituesve duhet të përfshijë:

- Trajnimin e medias mbi etikën dhe sigurinë;*
- Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit për aktivitetet;*
- Monitorimin e medias.*

Barazia dhe mosdiskriminimi në pjesëmarrje

- Njohja dhe zhvillimi i aftësive, si dhe talenteve të veçanta tek çdo individ është pjesë e procesit të fuqizimit. Megjithatë, në pjesëmarrje dhe përfaqësim kjo merr një rëndësi të veçantë.
- Profesionistët duhet të kujdesen që të eksplorojnë aktivitetet që kanë potencial pjesëmarrjeje të lartë. Aktivitete të tilla janë fotografitë, sportet, teatri, kërcimi, protestat. Profesionistët duhet të bëjnë gjithashtu kujdes që talentet të mos konkurojnë me njëra por tjetrën por të mbështesin njëri-tjetrin.

Mbështetja financiare për pjesëmarrje dhe përfaqësim


- Sigurimi i pjesëmarrjes kërkon financim të veçantë. Profesionistët duhet të marrin në konsideratë dhe të mbështesin nevojat financiare që dalin gjatë pjesëmarrjes, të cilat mund të jenë shpenzime transporti, shpenzime për printime, fotokopje, etj., shpenzime për të ngrënë jashtë shtëpisë, veshje të përshtatshme për aktivitetet etj..
- Nga ana tjetër, profesionistët duhet të konsiderojnë të mbijetuarit si ekspertë nga jeta, puna e të cilëve duhet të paguhet.

Komunikimi

Komunikimi është një nga kushtet kryesore për pjesëmarrjen. Profesionistët duhet të jenë të kujdesshëm sidomos të shmangin:

- Përdorimin e termit "viktimë": Në shumë raste përdorimi i këtij termi pa përcaktorin "trafikimit, krimi" ngjall reagime negative sepse ka konotacionin negativ me të qenit "i/e paaftë mendërisht";
- Përdorimin e termit "rast" për t'iu referuar individëve prezentë;
- Krahasimin e individëve përfitues me njëri-tjetrin;
- Referimin vazhdimisht tek njëri individ si model sjellje apo komunikimi;
- Injorimin dhe mospërfshirjen në komunikim të individëve të cilët kanë vështirësi në komunikim.

VIII. Përgjigja e MKR-së në emergjenca dhe kriza humanitare



8.1 Trafikimi i personave gjatë krizave humanitare


Bota aktualisht po përjeton kriza të shumta me pasoja të rënda humanitare. Konfliktet e armatosura, terrorizmi, ndryshimet klimatike, fatkeqësitë, pandemia COVID-19 dhe urgjenca të tjera shëndetësore, si dhe rritja e pasigurisë ekonomike dhe ushqimore po përkeqëson dobësitë ekzistuese të individëve dhe komunitetet globalisht duke krijuar rreziqe të reja dhe reduktimin e opsioneve të jetesës. Në mes të kësaj, dëshmitë vazhdojnë të ndërtojnë atë humanitar krizat dhe konfliktet çojnë në rritjen e trafikimit në persona dhe të drejta të tjera serioze të njeriut shkeljet. Për më tepër, keqpërdorimi në rritje e teknologjisë, duke përfshirë edhe në kohë krizash, ka zgjeruar shtrirjen gjeografike, duke ndihmuar trafikantët të operojnë përtej kufijve dhe në shumë vende vendndodhjet njëkohësisht.³⁰

Trafikimi i qenieve njerëzore mund të jetë present përpara, gjatë dhe pas një krize. Megjithatë, një reagim humanitar shpesh i shpërfill viktimat e trafikimit njerëzor si një grup përfitues që ka nevojë për ndihmë jetësore.³¹

Kur konflikti ose një fatkeqësi natyrore shkakton një emergjencë humanitare - shpesh gjatë ditëve dhe javëve të para - personeli humanitar fokusohet në ndihmën e njerëzve të prekur nga kriza, duke u ofruar atyre shërbime shëndetësore, ushqim, ujë, strehim të përkohshëm, etj. Kur adresohet një krizë humanitare (për shkak të një konflikti ose katastrofe natyrore) personeli humanitar duhet gjithashtu të adresojë rreziqet e trafikimit dhe të identifikojë dhe ndihmojë në mënyrë aktive viktimat e trafikimit. Në një përgjigje emergjente, trafikimi i qenieve njerëzore do të konsiderohet një çështje mbrojtjeje.

Mbrojtja nënkupton sigurimin e popullatës së prekur që të drejtat e tyre respektohen, mbrohen dhe përmbushen.

Mbrojtja e viktimave të trafikimit fillon me identifikimin dhe sigurinë dhe çon në ndihmë humanitare shumë-sektoriale, që i jep fund shfrytëzimit dhe inkurajon fuqizimin dhe mbështetjen te vetja.



8.2 Vulnerabiliteti ndaj trafikimit i personave në komunitetet e prekura nga kriza

Një numër faktorësh që i bëjnë njerëzit më të prekshëm ndaj trafikimit në situata krize, përfshijnë:

- Humbjet e mëdha njerëzore, materiale dhe ekonomike të shkaktuara nga krizat;
- Aftësia e kufizuar e familjeve dhe komuniteteve për të siguruar nevojat e tyre themelore;

³⁰ The Inter-Agency Coordination Group against Trafficking in Persons (ICAT) "A world in crisis: global humanitarian crises and conflicts increase human trafficking concerns call to action ["Një botë në krizë: Krizat humanitare globale dhe konfliktet rrisin shqetësimin për trafikimin e qenieve njerëzore. Thirrje për veprim"]": https://icat.un.org/sites/g/files/tmzbd461/files/publications/icat_call_to_action.pdf

³¹ IOM, Emergency Manual - Counter Trafficking in Humanitarian Settings [IOM, Manuali i Emergjencës – Masat kundër Trafikimit në situata humanitare]: <https://emergencymanual.iom.int/counter-trafficking-emergency-contexts>

- Mundësi të kufizuara për të kërkuar mbrojtje të brendshme ose ndërkombëtare në mënyrë të sigurt dhe rregullisht;
- Mekanizma përshtatës negativë të fituara nga ata që preken nga kriza; Erozioni i sundimit të ligjit;
- Prishja e rrjeteve të sigurisë sociale dhe sistemeve të tjera të mbrojtjes sociale.
- Në një krizë, rrjetet kriminale shpesh përfitojnë nga prishja e shtetit të së drejtës dhe prishja e institucioneve shtetërore.
- Familjet dhe individët e prekur nga krizat që kanë humbur mënyrën e mëparëshme të jetesës janë të prirur të miratojnë strategji negative për të përballuar jetën.
- Familjet dhe individët e prekur nga kriza që kanë frikë për jetën e tyre dhe dëshirojnë të kërkojnë mbrojtje jashtë vendit si refugjatë, mund të bien pre e trafikantëve që pretendojnë t'u ofrojnë një rrugë drejt sigurisë.
- Migrantët në vendet e prekura nga krizat mund të përballen gjithashtu me rreziqe në rritje të ekspozimit ndaj trafikimit për shkak të aksesit të tyre të kufizuar në ndihmë humanitare, mekanizmat kombëtar të mbrojtjes, rrjetet sociale dhe sisteme të tjera mbështetëse.
- Një krizë mund të krijojë një kërkesë për shërbime shfrytëzuese, siç është kërkesa e krijuar nga punonjësit e ndihmës dhe paqeruajtësit, të cilët mund të kërkojnë shërbime seksuale.

Në veçanti, përgjigjet anti-trafikim duhet të jenë:

- **Mbrojtëse**, duke synuar individë të prekur nga kriza që janë në një situatë veçanërisht të prekshme, si dhe ata që tashmë janë trafikuar, dhe duke siguruar një qasje me në qendër të mbijetuarit dhe të ndjeshme ndaj gjinisë;
- **Proaktive**, duke filluar nga nisja e një krize, edhe nëse rastet e trafikimit nuk janë raportuar ose konfirmuar ende;
- **Parandaluese**, duke identifikuar dhe u përgjigjur ndaj rrezikut aktual ose potencial dhe faktorëve mbrojtës;
- **Bashkëpunuese**, duke bashkuar anët e forta, kapacitetet dhe mandatet e zhvillimit dhe aktorët humanitarë nga sektorë të ndryshëm, si edhe aktorë kombëtarë, përfshirë autoritetet e zbatimit të ligjit.³²



8.3 Përgjigja e MKR në kohe krizash dhe emergjencash

"MKR-të plotësisht funksionale janë jetike për konsistencën e kornizave kombëtare kundër trafikimit gjatë situatave emergjente dhe ekuivalente, duke përfshirë pandemitë. Raportuesit kombëtarë duhet të monitorojnë dhe raportojnë për zbatimin e vazhdueshëm të detyrimeve shtetërore për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në situata emergjente, duke siguruar që zbatimi i duhur i një Protokoll Kombëtar i Gjendjes së Jashtëzakonshme (PKGJ) është në vend për ofrimin e të gjitha shërbimeve për viktimat e trafikimit".³³

³² The Inter-Agency Coordination Group against Trafficking in Persons (ICAT) "A world in crisis: global humanitarian crises and conflicts increase human trafficking concerns call to action ["Një botë në krizë: Krizat humanitare globale dhe konfliktet rrisin shqetësimin për trafikimin e qenieve njerëzore. Thirrje për veprim"]": https://icat.un.org/sites/g/files/tmzbd461/files/publications/icat_call_to_action.pdf

³³ OSCE/ODIHR and UN Women: "Addressing emerging human trafficking trends and consequences of the COVID-19 pandemic", 30 July 2020 [OSBE/ODIHR dhe UN Women: "Adresimi i trafikimit dhe pasojave të pandemisë Covid-19, 30 korrik 2020]: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/guidance-addressing-emerging-human-trafficking-trends-and-consequences-of-the-covid-19-pandemic>

Në kuadrin e MKR-së duhet hartuar një Procedurë apo Protokoll Kombëtar i Gjendjes së Jashtëzakonshme (PKGJ) në mënyrë që të përgatiten për gjendjet e jashtëzakonshme ose situata të tjera ekuivalente, duke përfshirë pandemitë. Është e rëndësishme që MKR-ja të jetë në gjendje për t'u përgjigjur me shpejtësi dhe në mënyrë efektive, prandaj (PKGJ) duhet të përcaktojë procedurat specifike të kërkuara dhe përdorimin e protokolleve të cilat përcaktojnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të MKR-së. Në momente emergjence, lindin një mori rreziqesh trafikimi dhe kryhen krime. Kjo përfshin, për shembull, rreziqet e rritjes trafikimit për shfrytëzim seksual në internet dhe rreziqe të konsiderueshme për fëmijët që nuk janë në gjendje të ndjekin shkollën, ose lihen në situata të cënueshme pa kujdes të sigurt dhe të përshtatshëm. Trafikantët mund të jenë më të aftë të kërcënojnë dhe synoni sërish viktimat e mëparshme dhe autorët e rinj mund të veprojnë pa u ndëshkuar ndërkohë që policia dhe shërbimet e urgjencës veprojnë dislokohet ndryshe. Varfëria dhe skamja në situata krize sjellin gjithashtu rreziqe serioze të trafikimit, ndaj është e nevojshme të merren masa përgatitore si:

- Trajnimi i të gjithë palëve të interesuara qeveritare dhe joqeveritare për ofrimin e shërbimeve **nga distanca** ndaj grupeve të rrezikuara;
- Prioriteti i testimit diagnostik në rastet e urgjencave shëndetësore dhe shpërndarjes së mbrojtjes personale pajisje (PPE) për profesionistët e vijës së parë, viktimat dhe të mbijetuarit si grup vulnerabël;
- Adresimi i aksesit dhe lidhjes në internet/EIFI për viktimat dhe të mbijetuarit për të siguruar që shërbimet në distancë janë në dispozicion të tyre gjatë një situatë emergjente ose krize;
- Mobilizimi i burimeve teknologjike për të lehtësuar aksesin e shërbimeve për viktimat dhe të mbijetuarit e trafikimit. Kjo është veçanërisht e nevojshme kur zbatohen masat e izolimit social dhe distancimit social, ose kur ka udhëtime e kufizuar/jo e mundur. Kërkon plotësimin e nevojave të viktimave për akses falas në shërbimet e ofruara nga distanca, duke përfshirë nëpërmjet përdorimit të telefonave të rregullt dhe teknologjive online;
- Zbatimi i vazhdueshëm i identifikimit proaktiv, mbrojtjes dhe mbështetjes individuale të viktimave të trafikimit, duke aplikuar një qasje shumëdisiplinore për të siguruar që dobësitë specifike të të rriturve dhe fëmijëve adresohen sa më shpejt që të jetë e mundur për të minimizuar rrezikun.



8.4 Mbrojtja dhe ndihma për personat e trafikuar gjatë një krize humanitare

Personat e trafikuar zakonisht kanë nevojë për një shumëllojshmëri të masave të menjëhershme dhe afatgjata të mbështetjes dhe mbrojtjes për të adresuar nevojat e tyre fizike, psikosociale, ligjore dhe materiale.


Neni 6 i Protokollit të Trafikimit të Personave përshkruan mbrojtjen dhe ndihmën që Shtetet Palë angazhohen të marrin në konsideratë për sigurimin, në bashkëpunim me organizatat përkatëse: **“Këshillim dhe informim në lidhje me të drejtat ligjore në një gjuhë që personi kupton, strehim të përshtatshëm, ndihmë mjekësore, psikologjike dhe materiale, arsim, trajnim dhe mundësi punësimi”**

Këto angazhime nuk zvogëlohen nga fillimi i një krize (pra janë të vazhdueshme). Viktimat e trafikimit kanë të njëjtat të drejta për mbrojtje dhe ndihmë në situata krize si në çdo periudhë tjetër.

Punonjësit që ofrojnë shërbim humanitar duhet të përpiqen të identifikojnë nevojat e menjëhershme të personit të trafikuar dhe të sigurojnë referimin e për shërbime në kohë dhe/ose projekte dhe programe përkatëse, në përputhje me MKR-në për të siguruar:

- Ndihmë materiale për të përmbushur nevojat themelore (ushqim, rroba);
- Strehim, akomodim, zhvendosje dhe transport;
- Ujë, pastrim dhe higjienë;
- Ushqim;
- Siguri personale dhe mbrojtje;
- Trajtim mjekësor dhe mbështetja psikosociale, të dyja këto mund të jenë në vazhdim;
- Arsim dhe trajnim;
- Mjete të jetesës, punësim dhe gjenerim të të ardhurave;
- Gjurmim, vlerësim dhe ribashkim i familjes;
- Akses në informacionin përkatës, kanalet e raportimit dhe proceset gjyqësore përfshirë mjetet juridike;
- Familjet dhe personat në ngarkim të personit të trafikuar gjithashtu mund të kërkojnë mbrojtje dhe ndihmë nëse dihet se rrezikojnë të dëmtohen.

IX. Monitorimi i Mekanizmit Kombëtar të Referimit



9.1 Koordinimi i veprimtarisë së MKR-së dhe monitorimi


Në Shqipëri, Zbatimi i MKR-së realizohet nga **Grupi Ndërinstitucional i Punës** për Bashkërendimin e MKR-së, i cili përbëhet nga përfaqësues të secilës prej palëve në Marrëveshje dhe **drejtohet nga Drejtuesi më i lartë i strukturës antitrafik në Ministrinë së Brendshme**. Struktura përgjegjëse antitrafik në Ministrinë e Brendshme shërben si Sekretariat Teknik i Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe Task Forcës.

Në nivel të veprimeve të anëtarëve të MKR-së përsa i përket referimit në procesin e identifikimit, referimit për ndihmë, mbrojtje, ri-integrim të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe përgjigjëse për regjistrimin dhe raportimin periodik të të dhënave për rastet e trafikimit të referuara nga institucione shtetërore dhe organizatat, është ngritur **Autoriteti Përgjegjës**, si strukturë mbështetëse e MKR-së.

Monitorimi i zbatimit të Marrëveshjes kryhet nga **Task Forca** për Marrëveshjen, e cila drejtohet nga Zëvendësministri i Brendshëm, përgjegjës për masat kundër trafikimit të personave. Task Forca për Marrëveshjen përbëhet nga një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues në secilin nga institucionet shtetërore palë.

Marrëveshja për MKR-në e firmosur në qershor 2023, parashikon për herë të parë dhe këshillimin me të mbi-jetuarit e trafikimit nëpërmjet **Bordit Këshillmor të Viktimave të Trafikimit, i cili funksionon nën drejtimin e Koalicionit Kombëtar të Strehëzave Anti-trafik**. Ky koalicion siguron që rekomandimet e dhëna nga viktimat në takimet konsultative i paraqiten anëtarëve të MKR-së.

Në mënyrë skematike bashkërendimi dhe monitorimi i MKR-së në Shqipëri paraqitet si më poshtë:



9.2 Konsiderata për MKR-në në Shqipëri

Disa hapa të sugjeruara që mund të ndiqen për të monitoruar zbatimin e MKR-së në Shqipëri:

- Përgatitja e Sistemit të Monitorimit**

Identifikoni dhe përcaktoni informacionin dhe të dhënat që duhet të monitorohen. Kjo përfshin informacione mbi numrin e rasteve të raportuara, llojet e shfrytëzimit, burimet e referimit, dhe shërbimet e ofruara për viktimat.

- Identifikimi i Indikatorëve Kryesorë**

Përcaktoni indikatorët kryesorë të performancës që do të përdoren për të vlerësuar efikasitetin e MKR. Për shembull, kohën mesatare të identifikimit të viktimave, numrin e rasteve të trajtuara, dhe përqindjen e rasteve të referuara me sukses.

- Regjistrimi dhe Dokumentimi i të Dhënave**

Sigurohuni që të gjitha të dhënat të regjistrohen dhe dokumentohen me kujdes. Kjo përfshin informacionin demografik të viktimave, detaje mbi rastin, dhe shërbimet e ofruara.

- Raportimi Periodik**

Zhvilloni një procedurë për raportim periodik të aktiviteteve të MKR-së. Këto raporte duhet të përfshijnë të dhëna sasiore dhe informacione cilësore mbi aktivitetet e MKR-së.

- Analiza dhe Vlerësimi**

Analizoni dhe vlerësoni të dhënat për të identifikuar tendencat, modelet dhe sektorët që mund të kenë nevojë për përmirësime. Vlerësoni efikasitetin e MKR-së në identifikimin dhe ndihmën ndaj viktimave të trafikimit.

- Respektimi i detyrimeve ligjore**

Sigurohuni që MKR-ja të përputhet me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me trafikimin e personave dhe mbështetjen e viktimave.

- Konsultim dhe Këshillim**

Kërkoni këshillim dhe vlerësim nga palët e interesuara të përfshira në procesin e MKR-së, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit, organizatat e jo-qeveritare, ekspertët ligjorë, dhe vetë viktimat.

- Përqendrimi tek Viktimat**

Sigurohuni që MKR-ja të ketë një qasje të qendrueshme ndaj viktimave. Ky përfshin ofrimin e shërbimeve të nevojshme si strehim, kujdes shëndetësor, ndihmë ligjore, dhe mbështetje psikologjike.

- Ndërgjegjësim dhe Informim**

Organizoni fushata të ndërgjegjësimit për të edukuar publikun, viktimat e mundshme, dhe profesionistët mbi ekzistencën dhe funksionin e MKR-së. Kjo mund të ndihmojë në rritjen e numrit të referimeve dhe në përmirësimin e efikasitetit të përgjigjes ndaj trafikimit të njerëzve.

- Bashkëpunimi dhe Koordinimi**

Ndihmoni në krijimin e partneriteteve të forta dhe koordinimit mes palëve të interesuara, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit, organizatat e jo-qeveritare, ofruesit e kujdesit shëndetësor, ekspertët ligjorë, dhe institucionet qeveritare.

• Përmirësimi i Vazhdueshëm

Sigurohuni që MKR të përmirësohet vazhdimisht duke u bazuar në mësimet të nxjerra, ndryshimet në kushte dhe praktikën e reja të mira.

Monitorimi i MKR-së duhet të sigurojë se viktimat e trafikimit marrin mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme dhe që mekanizmi vepron në mënyrë efektive për të adresuar këtë problem serioz.




9.3 Mjete të mundshme për të monitoruar Mekanizmin Kombëtar të Referimit

Për të monitoruar MKR-në mund të përdoren një sërë metodash dhe mjetesh, të sugjeruara më poshtë:

- **Pyetësor dhe Intervistime:** Zhvilloni pyetësore dhe intervistime me profesionistët dhe palët e tjera të përfshira në MKR për të marrë një vlerësim të opinionit dhe përvojave të tyre.
- **Vizita në Terren:** Kryeni vizita në terren për të vëzhguar drejtpërdrejtë procesin e identifikimit, referimit dhe trajtimit të viktimave.
- **Monitorimi i Kohës:** Shqyrtoni afatin kohor të çdo faze të procesit të MKR-së për të vlerësuar efikasitetin dhe për të identifikuar vonesa të mundshme.
- **Studimi i Rasteve:** Zhvilloni studime të hollësishme të rasteve për të kuptuar sfidat dhe sukseset specifike brenda rasteve individuale. Kjo qasje cilësore mund të ofrojë njohuri për zbatimin praktik të MKR-së.
- **Analiza e Statistikave:** Analizoni statistikën e ofruara nga institucionet dhe organizatat përfshirë në MKR për të vlerësuar tendencat dhe performancën globale.
- **Kërkimet Kualitative:** Përdorni kërkime kualitative për të kuptuar më mirë përvojat e viktimave dhe për të identifikuar problematikat që mund të mos evidentohen në statistika.
- **Forume dhe Takime Pjesëmarrje:** Organizoni forumë dhe takime me viktimat, organizata joqeveritare, dhe profesionistët të përfshirë në MKR për të dëgjuar zërin e tyre dhe për të shkëmbyer përvoja dhe sugjerime.
- **Mekanizmat për marrjen e opinionit të viktimave:** Krijimi i mekanizmave për viktimat për të dhënë komente mbi përvojat e tyre me MKR. Kjo mund të bëhet përmes anketave anonime, intervistave ose formularëve të komenteve.
- **Raportim Periodik:** Krijoni një mekanizëm raportimi periodik që mund të përdoret për të ndarë informacionin dhe gjetjet me publikun dhe palët e tjera të interesuara.
- **Përdorimi i Teknologjisë:** Përdorni teknologjinë për të lehtësuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave, duke përfshirë platforma online dhe aplikacione për raportim.
- **Konsultime me Ekspertë Ndërkombëtarë:** Kërkojeni këshillën dhe konsultën e ekspertëve ndërkombëtarë në luftën kundër trafikimit për të siguruar një perspektivë ndërkombëtare.
- **Rrjetet dhe Partneritetet:** Krijoni dhe ruani rrjetet dhe partneritetet me organizata ndërkombëtare, organizata joqeveritare dhe institucione tjera që mund të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje.

Përdorimi i këtyre mjeteve të bashkuara do të ofrojë një pamje më të plotë dhe të përgjithshme të performancës së MKR dhe do të ndihmojë në identifikimin e fushave potenciale për përmirësim.



9.4 Shembull i një pyetësori për Monitorimin e MKR-së

Për të zhvilluar një pyetësor për monitorimin e MKR-së, mund të përdorni pyetje që mbulojnë aspektet kyçe të funksionimit të MKR dhe ofrojnë një përfaqësim të gjerë të këtij procesi. Këtu janë disa sesione që mund të përfshihen në pyetësor dhe shembuj të pyetjeve:

- **Informacionin fillestar:** Si është rregulluar Mekanizmit Kombëtar të Referimit në Shqipëri dhe çfarë dokumentacioni është në dispozicion?
- **Procedurat dhe Protokollet:** A janë procedurat dhe protokollet e MKR-së të qarta dhe të njohura nga të gjithë palët e përfshira?
- **Identifikimi dhe Referimi:** Si bëhet identifikimi i viktimave të trafikimit dhe procesi i referimit në MKR?
- **Bashkëpunimi dhe Koordinimi:** A ka bashkëpunim dhe koordinim efektiv midis institucioneve dhe organizatave që janë pjesë e MKR?
- **Mbështetja dhe Asistenca:** Si është cilësia e mbështetjes dhe asistencës që ofrohet viktimave nëpërmjet MKR-së?
- **Afati kohor:** Sa kohë merr procesi i referimit dhe trajtimi i çdo rasti brenda MKR-së?
- **Përfshirja e Viktimave:** Si janë përfshirë viktimat në procesin e MKR dhe cila është përvoja e tyre?
- **Trajnimet dhe Ngritja e Kapaciteteve:** A janë profesionistët e përfshirë në MKR të trajnuar dhe të aftë për të kryer detyrat e tyre?
- **Feedback nga Palët e Përfshira:** A ka një mekanizëm të përhershëm të rregullt për të marrë feedback nga palët e përfshira në MKR?
- **Ndihma Ligjore dhe Drejtësia:** Si funksionon ndihma ligjore për viktimat dhe si sigurohet që ato kanë akses në drejtësi?
- **Transparenca dhe Informimi:** Sa transparent është MKR-ja dhe si informohen publiku dhe palët e tjera të interesuara rreth funksionimit të tij?
- **Ndihma Financiare dhe Kompensimi:** A ofrohet ndihmë financiare dhe kompensim për viktimat dhe si funksionon ky proces?
- **Problemet dhe Sfidat:** Cilat janë problemet dhe sfidat kryesore që has MKR në Shqipëri?
- **Rekomandimet për Përmirësim:** Çfarë rekomandimesh keni për përmirësimin e funksionimit të MKR?

Referencat

National Referral Mechanisms - Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons: A Practical Handbook – Second Edition OSCE, January 2022: https://www.osce.org/files/f/documents/f/5/510551_2.pdf

Raporti Vjetori i Departamentit Amerikan të Shtetit të vitit 2017 për trafikimin e personave: <https://www.state.gov/reports/2017-trafficking-in-persons-report/>

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

“Trafikimi i qenieve njerëzore - Manual për gjyqtarë, prokurorë dhe profesionistë të tjerë të drejtësisë”, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2021. <https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/512644>

Raporti i 3-të i Komisionit Evropian për Parlamentin Evropian dhe Këshillin mbi progresin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2020) në zbatim të Direktivës 2011/36/BE për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave: https://ec.europa.eu/anti-trafficking/sites/default/files/third_progress_report.pdf

SAMHSA's Concept of Trauma and Guidance for a Trauma-Informed Approach: https://ncsacw.acf.hhs.gov/userfiles/files/SAMHSA_Trauma.pdf

Zyra e Përgatitjes dhe Reagimit të Shëndetit Publik dhe Qendra Kombëtare për Kujdesin e Informuar për Traumën: <https://www.samhsa.gov/find-help/disaster-distress-helpline/coping-tips>

“Treating the Hidden Wounds: Trauma Treatment & Mental Health Recovery for Victims of Human Trafficking”, Heather J. Claëson, Ph.D., Amy Salomon, Ph.D., and Lisa Goldblatt Grace, LICSE, MPH: <https://www.ovcttac.gov/taskforceguide/eguide/4-supporting-victims/41-using-a-trauma-informed-approach/>

OSCE/ODIHR, Guidance on Trauma Informed National Referral Mechanism and Response to Human Trafficking, 2023 [OSBE/ODIHR: <https://www.osce.org/odihr/549793>

Siân Oram and Jill Domoney, Responding to the mental health needs of trafficked women. Healthcare, Counselling and Psychotherapy Journal <https://www.bacp.co.uk/bacp-journals/healthcare-counselling-and-psychotherapy-journal/april-2018/responding-to-the-mental-health-needs-of-trafficked-women/>

Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”

OSCE Office of the Special Representative and Co-ordinator for Combating Trafficking in Human Beings, Applying gender-sensitive approaches in combating trafficking in human beings (Vienna, 2021) <https://www.osce.org/cthb/486700>

Të ndryshëm dhe të Barabartë - Album me piktura nga viktimat e trafikimit “Une e lashe te kaluaren pas”: <https://differentandequal.org/sq/une-e-lashe-te-kaluaren-pas/>

“Trafficking in women and girls: crises as a risk multiplier Report of the Secretary-General”, UN (2022): <https://www.unwomen.org/sites/default/files/2022-10/A-77-292-SG-report-Trafficking-en.pdf>

Gender-specific measures in anti-trafficking actions”, EIGE, 2018. [“Masat e orientuara drejt gjinisë”, EIGE, 2018]: https://eige.europa.eu/publications-resources/publications/gender-specific-measures-anti-trafficking-actions-report?language_content_entity=en

European Institute for Gender Equality. Gender-specific measures in anti-trafficking, 2018 actions https://docs.euromedwomen.foundation/files/ermef-documents/8349_4.303.gender-specificmeasuresinanti-traffickingactions.pdf

Trafficking Victim Protection and Support: A Practitioner Guide”, NEXUS Institute Surtees, Rebecca and Laura S. Johnson (2021) <https://nexusinstitute.net/wp-content/uploads/2021/05/Trafficking-Victim-Protection-and-Support.-A-Practitioner-Guide-NEXUS-and-RSO-2021-1.pdf>

Udhëzues “Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi i Viktimave të Trafikimit”, Të Ndryshëm & Të Barabartë” 2022”: <https://differentandequal.org/sq/pjesemarrja-dhe-perfaqesimi-i-viktimave-te-trafikimit/>

The Inter-Agency Coordination Group against Trafficking in Persons (ICAT) “A world in crisis: global humanitarian crises and conflicts increase human trafficking concerns call to action https://icat.un.org/sites/g/files/tmzbd1461/files/publications/icat_call_to_action.pdf

IOM, Emergency Manual - Counter Trafficking in Humanitarian Settings: <https://emergencymanual.iom.int/counter-trafficking-emergency-contexts>

OSCE/ODIHR and UN Women: “Addressing emerging human trafficking trends and consequences of the COVID-19 pandemic”, 30 July 2020: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/guidance-addressing-emerging-human-trafficking-trends-and-consequences-of-the-covid-19-pandemic>

